



KOMPANIA RAJONALE UJËSIJELLËSIT SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.  
**PRISHTINA**





|                                                                                                |          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /<br>REPUBLIC OF KOSOVO<br>QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT |          |
| MINISTRIA E EKONOMISE<br>MINISTARSTVO EKONOMIJE<br>MINISTRY OF ECONOMY                         |          |
| Njesia Org.<br>Org. Jedlin<br>Org Unit                                                         | 01/3     |
| Nr. i faqesve<br>Broj stranica<br>No. pages                                                    | 68       |
| Nr. Prof.<br>Br. Prof.<br>Prof.No:                                                             | 2795     |
| Usta:<br>Datum:                                                                                | 01.11.21 |
| PRISHTINE A NO.1                                                                               |          |

## PLANI I BIZNESIT TË KRU “PRISHTINA” Sh.A., PËR PERIUDHËN 2022-2024

### Vendimi: (I-07)

Bordi i përkohshëm i Drejtorëve të KRU “Prishtina” sh.a., i emëruar me Vendimin e Qeverisë nr.11/17, të datës 25.06.2021, në mbledhjen e pestë të rregullt të mbajtur me datë 29.10.2021 pas shqyrtimit dhe analizimit paraprak të Planit të Biznesit të KRU “Prishtina” sh.a., për periudhën 2022-2024, unanimisht aprovoj Planin e Biznesit (2022-2024).

Plani i Biznesit të KRU “Prishtina” sh.a., do të dorëzohet në NJPMNP në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

|                   | Delegoj                                                                             | Aprovoj                                                                               |
|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri dhe mbiemri: | z.Sokol Xhafa<br>U.D./Kryeshef Ekzekutiv                                            | Kryesuesja e BpD-së<br>znj.Nora Tafarshiku-Kurtishi                                   |
| Nënshkrimi:       |  |  |
| Datë:             | 29.10.2021                                                                          | 29.10.2021                                                                            |





KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
RAGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

**PRISHTINA**



# PLANI I BIZNESIT

## 2022 - 2024

Prishtinë, tetor 2021

## PËRMBLEDHJE

Kompanitë publike të ujit të pijshëm kanë obligim përpilimin e Planit të biznesit si dhe përfitimet e pritshme nga çdo plan biznesi. Kompanitë e ujësjellësit nuk lejohet me qenë biznes fitimprurës, andaj edhe planifikimet janë bërë bazuar në këtë kontekst.

Për qëndrueshmëri, plani i referohet një manuali të bazuar në informacionet reale të viteve të kaluara. Qëllimi i planit është, të vendosim si raportim vlerën e asetëve të kompanisë, nevojat bazë të zonës së shërbimit, si janë ato nevoja, që të trajtohen, dhe si kompania do të funksionojë, do të mbajë qëndrueshmëri me kalimin e kohës gjatë periudhës planifikuese. Çdo ndërmarrje e ujit, që aplikon për një leje shërbimi në ministrinë e linjës duhet të përgatisë një Plan biznesi dhe ta dorëzojë atë në Ministrinë e Ekonomisë respektivisht në Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Faza e fillimit është koha më e rëndësishme për të pasur një Plan biznesi, sepse ai mund të ndihmojë në parandalimin e investimeve në ndërmarrje, që mund të përcillen me probleme e pasi që kjo i ndihmon menaxhmentit, operatorit, klientit, komunitetit, huadhënësit dhe rregullatorit.

Para se të bëjmë një investim të rëndësishëm në ndërmarrje, është e nevojshme të identifikojmë rreziqet që ekzistojnë dhe japin garanci se projekti i propozuar do të jetë i aftë të përmbushë kërkesat e shërbimit dhe sigurimin e një furnizimi të sigurt dhe adekuat me shërbime për konsum në vazhdimësi.

Plani i biznesit ka për qëllim, të tregojë se një sistem mund të mbetet i zbatueshëm. Përkufizimi i ujit të pijshëm është i vetë qëndrueshëm, ka angazhimin financiar dhe institucional, si dhe ka aftësinë financiare, menaxheriale dhe teknike për të përmbushur me besueshmëri performancën për kërkesat për një periudhë kohe.

Plani i biznesit për shërbime të ujit të pijshëm do të demonstrojë:

- Se projekti është mjaft i fortë, për të mbetur i zbatueshëm edhe nën ndikimin e ndryshimeve të pafavorshme në mjedisin ku funksionon.
- Që plani i propozuar të jetë brenda kufijve praktikë, plani më i mirë i mundshëm.

Ky është plani më i zbatueshëm, për ofrimin e shërbimit të ujit për komunitetin.

Plani i biznesit mund të përgatitet nga çdo individ me njohuri të nevojshme dhe çdo gjë të ngjashme me projektet ekzistuese, dhe me financat e projektit. Pronari ose operatori i projektit të propozuar do të kishte një çasje të mundshme për të zhvilluar planin. Shpesh, inxhinieri i projektit, këshilltari financiar ose ndonjë tjetër konsulent do t'i jepet detyra e përgatitjes dhe plotësimi të Planit të biznesit. Ndonjëherë planifikimi do të përgatit planin, ose do të ofrojë ndihmë në përgatitje. Sidoqoftë, pavarësisht se kush e përgatit planin, përgjegjësia për vlefshmërinë e tij përfundimtare si dhe zbatimin e mbetet menaxhmentit të kompanisë. Rëndësi të veçantë ka menaxhmenti që të luajë një rol në zhvillimin e planit, duke përfshirë të gjitha projeksionet, të kuptuarit se si të gjitha projektet apo caqet janë analizuar dhe janë identifikuar, për të kuptuar rreziqet e ndryshme gjatë përpilimit si dhe implementimit të tij.

## Përmbajtja

|                                                                                                           |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. PROFILI I KRU “PRISHTINA” SH.A.....</b>                                                             | <b>5</b>  |
| 1.1 Historiku i kompanisë.....                                                                            | 5         |
| 1.2 Lokacionet e kompanisë .....                                                                          | 6         |
| <b>2. METODOLOGJIA E PËRPILIMIT TË PLANIT TË BIZNESIT 2022 - 2024.....</b>                                | <b>7</b>  |
| 2.1 Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërmarrje .....                                          | 8         |
| <b>3. DEKLARATAT E KRU “PRISHTINA” Sh.A. ....</b>                                                         | <b>9</b>  |
| 3.1 Deklarata e Vizionit .....                                                                            | 9         |
| 3.2 Deklarata e Misionit .....                                                                            | 9         |
| 3.3 Deklarata e rrezikut (riskut) .....                                                                   | 9         |
| <b>4. PROFILI I KONSUMATORËVE TË KRU “PRISHTINA” Sh.A. ....</b>                                           | <b>10</b> |
| 4.1 Zona e Shërbimit .....                                                                                | 11        |
| 4.2 Burimet e ujit të KRU “PRISHTINA” Sh.A. ....                                                          | 11        |
| 4.3 Rrjeti shpërndarës i ujit të pijes .....                                                              | 13        |
| 4.4 Rrjeti shpërndarës i ujërave të ndotura .....                                                         | 15        |
| <b>5. TARIFA E SHËRBIMIT .....</b>                                                                        | <b>18</b> |
| 5.1 Tarifat e shërbimit për vitin 2021 (në kuadër të këtyre tarifave është ndërtuar Plan i biznesit 2022) | 19        |
| 5.2 Tarifat për aktivitetet themelore të lidhjes së konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe           |           |
| kanalizimit.....                                                                                          | 19        |
| 5.3 Tarifat për aktivitetet tjera themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura .....    | 21        |
| <b>6. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KRU “PRISHTINA” Sh.A.- PERIUDHA 2022– 2024.....</b>                       | <b>21</b> |
| 6.1 Objektiva strategjike 1: Reduktimi i humbjeve të ujit (uji pa të ardhura) .....                       | 21        |
| 6.2 Objektiva strategjike 2: Mbledhja e borxheve të prapambetura përkatësisht zvogëlimi i llogarive të    |           |
| arkëtueshme .....                                                                                         | 23        |
| 6.3 Objektiva strategjike 3: Rritja e mbulueshmërisë së në zonën e shërbimit - furnizimit me ujë të pijes |           |
| (mbulimi i tërësishëm i zonës) .....                                                                      | 24        |
| <b>7. GJENDJA AKTUALE NË KRU “PRISHTINA” Sh.a. ....</b>                                                   | <b>25</b> |
| 7.1 Performancat financiare gjatë vitit 2021 .....                                                        | 25        |
| 7.2 Performanca operative në vitin 2021 .....                                                             | 27        |
| 7.3 Pasqyra krahasuese e treguesve operativë dhe financiarë 2020 & 2021 .....                             | 27        |
| 7.4 Rekrutimi i personelit të ri gjatë vitit 2022 .....                                                   | 28        |
| <b>8. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PLANIFIKIMI I PERSONELIT .....</b>                                       | <b>29</b> |
| 8.1 Struktura organizative .....                                                                          | 29        |

|      |                                                                                  |    |
|------|----------------------------------------------------------------------------------|----|
| 8.2  | Struktura menaxhuese .....                                                       | 29 |
| 8.3  | Skema organizative - Organogrami .....                                           | 30 |
| 8.4  | Numri total i personelit operativ - teknik dhe financiar - administrativ .....   | 32 |
| 8.5  | Ristrukturimi i personelit.....                                                  | 32 |
| 8.6  | Struktura kualifikuese dhe gjinore .....                                         | 32 |
| 8.7  | Struktura nacionale .....                                                        | 33 |
| 8.8  | Struktura moshës së personelit.....                                              | 33 |
| 8.9  | Numri i personelit në raport me numrin e konsumatorëve .....                     | 34 |
| 9.   | BUXHETI I KRU "PRISHTINA" Sh.A. ....                                             | 35 |
| 9.1  | Buxheti vjetor për vitin 2022 dhe parashikimet për periudhën 2023- 2024 .....    | 35 |
| 9.2  | Buxheti mujor për vitin 2022 .....                                               | 38 |
| 9.3  | Faturimet dhe arkëtimet e shërbimeve bazë .....                                  | 38 |
| 9.4  | Buxheti- arkëtimet, shpenzimet, investimet kapitale dhe mbetja neto.....         | 43 |
| 9.5  | Struktura e faturimit sipas kategorive për vitin 2022 .....                      | 44 |
| 9.6  | Struktura e arkëtimeve sipas kategorive për vitin 2022 .....                     | 44 |
| 9.7  | Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes për vitin 2022 .....                   | 45 |
| 9.8  | Shpenzimet e personelit për vitin 2022 .....                                     | 46 |
| 9.9  | Shpenzimet vjetore të operimit dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2019-2024 ..... | 48 |
| 10.  | INVESTIMET KAPITALE NË KRU "PRISHTINA" Sh.A. ....                                | 49 |
| 10.1 | Investimet në rrjetin e ujësjellësit nga grantet, subvencione e kredi .....      | 50 |
| 10.2 | Investimet në rrjetin e kanalizimit nga grantet, subvencione dhe kredi .....     | 51 |
| 10.3 | Lista e investimeve kapitale 2022-2024 .....                                     | 51 |
| 10.4 | Treguesit teknik dhe financiar të performancës 2020 – 2024 .....                 | 54 |
| 10.5 | Pasqyra e të hyrave tjera operative vjetore 2022-2024 .....                      | 55 |
| 10.6 | Të hyrat e tjera.....                                                            | 56 |
| 10.7 | Analiza e shpenzimeve të mundshme të humbura.....                                | 57 |
| 11.  | PLAN PROGRAMI I AMORTIZIMIT TË KREDIVE.....                                      | 60 |
|      | Plani i amortizimit të kamatave dhe principalit, Faza II.....                    | 60 |
|      | Plani i amortizimit të kamatave dhe principalit, Faza III.....                   | 61 |
| 12.  | SHTESAT .....                                                                    | 62 |
| 12.1 | Lëvizja mujore e parasë së gatshme për vitin 2022 .....                          | 64 |
| 12.2 | Performanca financiare .....                                                     | 65 |
| 12.3 | Performanca operative /financiare .....                                          | 65 |

## Shkurtesat – Akronimet

|        |                                                         |
|--------|---------------------------------------------------------|
| ARRU   | Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit             |
| ASK    | Agjencioni i Statistikave të Kosovës                    |
| BPRR   | Biznes Planet Rregullatore                              |
| BRRA   | Baza Rregullatore e Aseteve                             |
| BD     | Bordet e Drejtorëve                                     |
| IKSHPK | Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës        |
| IÇKK   | Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë                  |
| KNMU   | Këshillit Ndërmnistror për Ujëra                        |
| KRU    | Kompania Rajonale e Ujësjiellësit                       |
| NJPMNP | Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike |
| QU     | Qendra e Ujit                                           |
| UPF    | Uji i pa-faturuar                                       |
| UA     | Udhëzimi Administrativ                                  |
| UKRR   | Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator                  |
| OSH    | Ofruesit e Shërbimeve                                   |
| SIG    | Sistemi Informativ Gjeografik                           |
| TKP    | Treguesit Kyç të Performancës                           |
| GNI    | Grupi Ndërinstitucional                                 |
| SHUKOS | Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimit të Kosovës      |
| NJOU   | Njësia Operative e Ujësjiellësit                        |
| BV     | Biznese të Vogla                                        |
| BM     | Biznese të Mëdha                                        |
| ITUP   | Impiant i Trajtimit të Ujit të Pijes                    |

## HYRJE

### Prishtina - Kryeqyteti i Republikës së Kosovës - selia qendrore e KRU "Prishtina" Sh.A.

Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës. Prishtina shtrihet buzë rrafshnaltës së pëlleshme rrëzë maleve të argjendta, ashtu sikurse dikur Ulpiana. Ka pozitë të përshtatshme gjeografike, ngase gjendet në kryqëzimin e rrugëve parësore kontinentale. Pozita e këtillë gjeostrategjike ka bërë që historia e Prishtinës të përcillet nga shumë ngjarje të rëndësishme historike.

Qyteti ka dy lumenj tanimë të shterur (të mbuluar me kanale të betonit). Rrethohet nga një kurorë bregore që përbëhet nga Veterniku dhe Mati në anën jugore, pyjet e blerta të Gërmisë në lindje dhe Arbëria në perëndim.

Prishtina ka lartësinë mesatare mbidetare prej 585 deri në 600 metra. Dominohet nga një klimë e zbutur kontinentale. Të shumtën e kohës mbizotërojnë (klima) ditë të nxehta dhe netë të freskëta malore.

Prishtina, tanimë shpërfaqet si një qytet i bukur dhe bashkëkohor, gërshtuar me gjurmë e tipare karakteristike të kulturave të lashta ilire, romake, bizantine e osmane, nga aspekti historik, por me një urbanizëm kaotik e të shfrenuar.

## 1. PROFILI I KRU "PRISHTINA" SH.A.

### 1.1 Historiku i kompanisë

Zhvillimi ndër vite i KRU "Prishtina" Sh.A., apo vetë sistemit të ujësjellësit, është i lidhur ngushtë me historikun e zhvillimit në të gjitha fushat në Prishtinë, në cilësinë e kryeqytetit të Kosovës, si dhe vendbanimeve (sidomos dy qendrave të mëdha tashmë administrative: Fushë Kosovë dhe Obiliq) që gravitojnë afër kryeqendrës. Pas luftës së Kosovës (1998-1999) kompania i është nënshtruar procesit të konsolidimit përkatësisht regionalizimit. Aktualisht zona e shërbimit është e shtrirë në gjithë territorin e Kosovës qendrore.

Furnizimi me ujë i Prishtinës, daton që nga kohët e hershme nga burimet natyrore të Gërmisë kurse më vonë nga pusët në Kolevicë. Prishtina në vitin 1961 kishte përafërsisht 38,593 banorë. Në këtë vit fillon shfrytëzimi i liqenit akumulues të Badovcit për furnizimin e qytetit të Prishtinës dhe rrethinës me ujë të pijes.

Në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar, paralelisht me rritjen dhe zhvillimet urbanistike në qytetin e Prishtinës dhe rrethinës fillon rritja e kërkesave për ujë të pijes dhe largimin e ujërave të ndotura. Bëhet një kapërcim përtej mundësive dhe parashikimeve dhe shtohen sasitë e ujit të pijes duke shfrytëzuar akumulimin e liqenit të Batllavës, burimeve nëntokësore në Fushë Kosovë dhe Obiliq. Përveç shtimit të sasisë së ujit, në këtë periudhë janë bërë edhe investimet kualitative në rrjetin shpërndarës të ujit të pijes dhe ujërave të ndotura.

Në vitin 2007 kompania, shndërrohet në shoqëri aksionare me emërtimin: **Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" - Shoqëri Aksionare.**

Kompania ka të organizuar ofrimin e shërbimeve të ujit të pijes dhe largimit të ujërave të ndotura në komunat: **Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Lipjan, Podujevë, Gllogoc dhe Graçanicë (pjesërisht edhe në komunën e Vushtrrisë).**

**KRU "Prishtina" Sh.A.** është kompania më e madhe e furnizimit me ujë të pijes në Republikën e Kosovës.

## 1.2 Lokacionet e kompanisë

Më 12.10.2016 kompania është riemërtuar me emrin: **Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A.** - KRU "Prishtina" Sh.A. është entitet unik, i regjistruar në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë në numrin unik të biznesit 810547549.

Selia qendrore e kompanisë gjendet në Prishtinë (kodi postal 10,000), në rrugën "Hazir Shala" numër 4, telefoni +383 38 603211, +383 44 520270 (gjithashtu edhe viber) dhe +383 45 705112, Qendra e thirrjeve +383 38 606020, dhe thirrjet pa pagesë në Qendrën e thirrjeve në numrin 0800 900 09. Posta elektronike: info@kru-prishtina.com, ueb faqe: kru-prishtina.com.

Në selinë qendrore të kompanisë kryhen të gjitha veprimet e administrimit financiar, logjistik, administrativ dhe të përfaqësimit me palët e treta. Njësitë operative të ujësjiellësit janë pjesë integrale të kompanisë unike, të organizuara nëpër komunitatet e zonës së shërbimit si në vijim:

### 1.2.1 Njësia operative e ujësjiellësit - NJOU në Prishtinë

Në Prishtinë njëkohësisht është edhe selia qendrore e kompanisë si dhe bartësja e procesit të konsolidimit dhe inkorporimit të njësive tjera. Përveç punëve dhe përgjegjësi të bartura dhe të rikrijuara, ka marrë në kompetencë edhe kryerjen e të gjitha punëve të përbashkëta administrative dhe financiare për të gjitha njësitë (Planifikimi, prokurimi, administrata e përgjithshme, kontabiliteti dhe thesari etj.). Komunikimi zyrtar dhe adresa e njëjtë sikur e prezantuar në paragrafin paraprak.

### 1.2.2 Njësia operative e ujësjiellësit - NJOU në Fushë Kosovë

Në Fushë Kosovë kompania nuk ka në pronësi objekt në të cilin zhvillon aktivitetet e operimit. Në kuadër të njësive kryhen vetëm disa veprime të thjeshta operative dhe financiare (leximi i ujëmatësëve, faturimi, arkëtimi dhe evidentimi i kërkesave - ankesave të konsumatorëve). Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyrat (selinë) qendrore në Prishtinë. Aktualisht, objekti në rrugën "7 Shtatori", p.n. është i marrë me qira për një periudhë të caktuar kohore. Komunikimi me NJOU në Fushë Kosovë bëhet përmes telefonit mobil: +38345705113.

### 1.2.3 Njësia operative e ujësjiellësit - NJOU në Obiliq

Në Obiliq zhvillohen aktivitetet të kufizuara ditore të natyrës operative dhe financiare. Këto veprime zhvillohen në objektin administrativ që është në pronësi të kompanisë, në rrugën "Hasan Prishtina", pa numër. Të gjitha veprimet tjera i delegon te personeli i caktuar në selinë qendrore në Prishtinë. Komunikimi zyrtar me NJOU në Obiliq bëhet në nr: +383 38 560 013 dhe cel: +38345705114.

### 1.2.4 Njësia operative e ujësjiellësit - NJOU në Graçanicë

Në Graçanicë nuk ka pronësi objekt në të cilën zhvillon aktivitetet e operimit (me këtë Plan të biznesit është paraparë ndërtimi i një objekti afarist gjatë vitit 2021 përkatësisht 2022 në parimin me "çelësa në dorë"). Në kuadër të njësive kryhen veprime operative dhe financiare (lexim të ujëmatësëve, faturim, arkëtim dhe evidentim të kërkesave-ankesave të konsumatorëve). Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në Zyrat (selinë) qendrore në Prishtinë. Aktualisht objekti në rrugën "Car Lazar", pa numër është i marrë me qira për një periudhë të caktuar kohore. Komunikimi zyrtar bëhet përmes nr. Cel: +38345705115.

### 1.2.5 Njësia operative e ujësjiellësit - NJOU në Shtime

Në Shtime, një numër i kufizuar i veprimeve operative dhe financiare kryhen në objektin administrativ dhe bazën teknike që ndodhet në rrugën "Isa Boletini", numër 5 në Shtime. Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në Zyrat (selinë) qendrore në Prishtinë. Komunikimi zyrtar bëhet përmes nr. Cel: +3834570516.

### 1.2.6 Njësia operative e ujësjellësit - NJOU në Lipjan

Në Lipjan një numër i kufizuar të veprimeve operative dhe financiare kryhen në objektin administrativ dhe bazën teknike që ndodhet në rrugën, "12 Qershori" në Lipjan. Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në Zyrat (selinë) qendrore në Prishtinë. Komunikimi zyrtar bëhet përmes nr: + 381 38 582829 dhe nr. cel: +3834570517.

### 1.2.7 Njësia operative e ujësjellësit - NJOU në Podujevë

Në Podujevë një numër të kufizuar të veprimeve operative dhe financiare kryhen në objektin administrativ dhe bazën teknike që ndodhet në rrugën e "Brigadave", pa numër. Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në Zyrat (selinë) qendrore në Prishtinë. Komunikimi zyrtar bëhet përmes nr. tel. +383 38 570507 dhe nr. cel: +38345705118.

### 1.2.8 Njësia operative e ujësjellësit - NJOU në Drenas

Në Drenas që nga vitit 2020 është në pronësi objekti afarist dhe i bazës teknike në rrugën "Muhamet Qorri" pa numër. Në këtë zhvillohen aktivitetet e operimit. Në kuadër të njësisë kryhen vetëm disa veprime të thjeshta operative dhe financiare (leximi i ujëmatësve, faturim, arkëtim dhe evidentim i kërkesave-ankesave të konsumatorëve). Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në Zyrat (selinë) qendrore në Prishtinë. Komunikimi zyrtar bëhet përmes nr. tel +383 38 384708 dhe nr. cel: +38345705118.

## 2. METODOLOGJIA E PËRPILIMIT TË PLANIT TË BIZNESIT 2022 - 2024

Në kohën e përgatitjes së Planit të biznesit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) përmes njoftimit zyrtar dhe në pajtim me të gjitha kompanitë e ujësjellësve ka bërë të ditur se ka filluar procesin tarifar 2022 - 2024. Ndërkaq veçmas përmes Urdhërësës Tarifore (përmes një procedurës formale por të reduktuar) ka përcaktuar Tarifat e shërbimit për vitin 2021 me të vetmin qëllim ruajtjen e shëndetit në kohë të pandemisë të të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë në këtë proces shumë të rëndësishëm. Prandaj ky dokument (Plani i biznesit) është përgatitur duke marrë për bazë Tarifën aktuale të vitit 2021 dhe në ndërkohë me ARRU-në do t'i harmonizojmë të gjithë treguesit teknik e financiar që kanë ndikim në tarifën e shërbimit për vitin 2022.

Plani i biznesit është dokument i cili përgatitet edhe si detyrim që del nga neni 30 i Ligjit mbi kompanitë publike nr. 03/L-087 dhe me nenin 17, 18 të Ligjit 04/L-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Me këtë Plan, janë përcaktuar orientimet dhe objektivat zhvillimore të kompanisë duke marrë për bazë rezultatet e pritshme. Janë marrë në konsideratë edhe rezultatet (historike).

Plani i biznesit është përgatitur duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të kompanisë, trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë dhe regjion, me qëllim që të adoptohen praktikatat më të mira për një zhvillim të qëndrueshëm financiar dhe tekniko-teknologjik të KRU "Prishtina" Sh.A. Gjithashtu në të gjitha fazat e hartimit, zhvillimit dhe implementimit të të gjithë dokumenteve strategjike është marrë në konsideratë edhe konteksti ekonomik dhe socio-kulturor në Republikën e Kosovës.

Parametrat financiar dhe operativ janë konservativ, në mënyrë që të jenë të arritshëm (duke lënë mundësinë e tejkalimit të tyre).

Plani i biznesit, merr parasysh strategjinë zhvillimore të institucioneve të Republikës së Kosovës për sektorin e ujit, si në nivel qeveritar edhe në nivel komunal, njëkohësisht edhe Direktivat Evropiane për ujin e pijes dhe ujërat e ndotura.

Aksionari, përmes Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky Plan, në mënyrë që KRU "Prishtina" Sh.A. të arrijë të përmbushë vizionin dhe misionin e kompanisë.

Plani i biznesit për periudhën 2022-2024, pasi të jetë miratuar nga Bordi i Drejtorëve, i njëjti veçanërisht ai i vitit bazë (2022) do të zërthehet në mënyrë që të përgatiten planet e detajuara të implementimit të të gjitha objektivave dhe vlerave të planifikuara.

## 2.1 Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërmarrje

KRU "Prishtina" Sh.A. është e organizuar në cilësinë e shoqërisë tregtare. Aksionet janë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Veprimtarinë e saj operative dhe financiare do t'a organizojë dhe përmbushë, duke pasur për bazë detyrimet në zbatimin e akteve dhe dispozitave ligjore të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

- Ligji nr. 04/L 006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare;
- Ligji mbi shoqëritë tregtare 02/L-123 (i shfuqizuar);
- Ligji mbi kompanitë publike (nr. 03/L-087);
- Ligjit nr. 04/L-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për kompanitë publike;
- Ligji nr.05/L -009 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për kompanitë publike nr. 03/L-087 për kompanitë publike i ndryshuar dhe plotësuar nr. 04/L-111;
- Ligji mbi afruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave (nr. 03/-L-086);
- Ligji mbi menaxhimin e financave publike (2008/03 L048);
- Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (2012/04-L-116);
- Ligji mbi ujërat (04/L-147);
- Ligji i punës (2010/03-L-212);
- Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave personale (2010/03-L-172); dhe
- Ligji mbi festat zyrtare (03/L-064).

### 3. DEKLARATAT E KRU "PRISHTINA" Sh.A.

#### 3.1 Deklarata e Vizionit

*Ndërmarrje lidere ne rajon, për trajtimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin - trajtimin e ujërave të ndotura, për konsumatorët e saj në përputhshmëri me standardet e ndërmarrjeve të mëdha në rajon dhe Evropë.*

#### 3.2 Deklarata e Misionit

*Trajtimi cilësor i ujit, furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm të qytetarëve të Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Graçanicës, Shtimes, Lipjanit, Podujevës dhe Drenasit si dhe trajtimi i ujërave të ndotura në përputhshmëri me standardet dhe kërkesat statusore dhe legislative të KRU "Prishtina" Sh.A., dhe aksionarit.*

#### 3.3 Deklarata e rrezikut (riskut)

Përgatitja e Planit të biznesit nisët mbi bazën e parimit të vazhdimësisë në një periudhë shumë të gjatë kohore (uji është elementi kryesor i jetës, së konsumatorëve, prandaj vazhdimësia është e padiskutueshme). Rreziqet e mundshme në aspektin e parashikimit për periudhën, të cilën përfshinë Plani i biznesit dhe pamundësia e përmbushjes së vizionit dhe misionit të kompanisë si dhe objektivave të parapërcaktuara mund të përmblihen si:

- Mungesa eventuale e rezervave të ujit në burim (mungesë e reshjeve atmosferike);
- Dëmtimi i kualitetit të ujit si pasojë e ndryshimeve klimatike (stinore);
- Ngritja e kostos së jetesës (rritja e tarifës së energjisë elektrike, karburanteve, pjesëve të ndërrimit etj.);
- Zvogëlimi i vazhdueshëm i tarifës së shërbimit për konsumatorët e jo amvisërisë (referuar politikës tarifore);
- Kontaminimet eventuale të burimeve të ujit;
- Forcat tjera madhore (tërmeti, vërshimet, zjarret, ndryshimet klimatike etj.);
- Pandemia "Covid 19".

Në kohën kur po përgatitet ky Plan i biznesit karakterizohet me një situatë të paqëndrueshme dhe vështirë e definueshme në shtrirjen kohore, ndikimin negativ në jetën e qytetarëve të Kosovës, pastaj pasojat shkatërruese për ekonominë kombëtare dhe përgjithësisht ekonominë globale. Pandemia "Covid-19" që ka filluar (në Kosovë) në mesin e muajit mars 2020 e që vazhdon me ritëm më të madh edhe tani, ka pasur ndikim në shumë nga treguesit e performancës: faturimin me të vogël (mbyllja e bizneseve të ndryshme, shkollave, çerdheve, puna në institucionet shtetërore me personel të kufizuar etj.), rritja e një kategorie të shpenzimeve me qëllim të përballimit të pandemisë.

Ashpërsimi i masave me qëllim të parandalimit të infektimit nga ana e institucioneve shtetërore nga njëra anë (që shkakton rënie të konsumit të ujit), mbyllja e bizneseve e mbi të gjitha nëse pamundësohet pagesa e pagave për shërbuesit civil, pasojat në likuiditetin e kompanisë do të jenë të pariparueshme për një kohë të gjatë. Kufizimi i shpenzimeve jo të domosdoshme dhe rishikimi i Planit të investimeve kapitale, vetëm në ato që orientohen kah koncepti i sigurisë së furnizimit janë vendimtare me të cilat mundet në mënyrë cilësore të menaxhohen nga faktori i brendshëm.

#### 4. PROFILI I KONSUMATORËVE TË KRU “PRISHTINA” Sh.A.

Urdhëresa tarifore e cila është në zbatim për periudhën 2018 - 2021, duke përfshirë edhe procesin aktual për vitin 2022, specifikon vetëm dy kategori të konsumatorëve (për shkak të përhapjes së Pandemisë “Covid-19” edhe në Kosovë. Autoriteti Rregullator i Ujit në bashkëpunim me kompanitë që furnizojnë me ujë të pijes kanë vendosur që Procesi tarifar 2022-2024 të reduktohet dhe i njëjti të jetë shumë i reduktuar): shtëpiak (amvisëri) dhe jo shtëpiak (institucione, biznese, industri etj.).

KRU “Prishtina” Sh.A. për nevoja të një planifikimi dhe monitorimi më të mirë, ka ndarë më tutje në katër kategori të konsumatorëve:

- Amvisëria;
- Bizneset e vogla;
- Bizneset e mëdha; dhe
- Institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në përfundim të muajit dhjetor 2021, numri i konsumatorëve aktiv që marrin shërbime është 148,510 sipas planifikimit nga Plani i biznesit ndërsa bazuar në periudhën 01-08/2021 me të dhëna faktike si dhe 09-12/2021 me të dhëna të planifikuara, parashihet të arrijë në 153,500 konsumatorë.

Kategorizimi dhe struktura në përqindje e konsumatorëve të KRU “Prishtina” Sh.A. është si në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 1 Numri i konsumatorëve sipas kategorive nëpër NJOU 2021**

| Elementet                                                                                                      | €  | Prishtina     | Fushë Kosova  | Obiliqi      | Graçanica    | Shtime       | Lipjani       | Podujeva      | Drenasi      | Total          |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|---------------|---------------|--------------|--------------|--------------|---------------|---------------|--------------|----------------|
| Amvisëria                                                                                                      | nr | 76,746        | 21,015        | 5,559        | 3,645        | 3,379        | 9,757         | 10,718        | 5,289        | <b>136,108</b> |
| Bizneset e vogla                                                                                               | nr | 10,038        | 1,467         | 356          | 223          | 318          | 741           | 1,182         | 742          | <b>15,069</b>  |
| Bizneset e mëdha                                                                                               | nr | 1,034         | 59            | 69           | 69           | 19           | 138           | 33            | 23           | <b>1,444</b>   |
| Institucionet                                                                                                  | nr | 511           | 56            | 47           | 37           | 42           | 72            | 78            | 36           | <b>879</b>     |
| <b>Total</b>                                                                                                   | nr | <b>88,329</b> | <b>22,596</b> | <b>6,031</b> | <b>3,975</b> | <b>3,759</b> | <b>10,708</b> | <b>12,011</b> | <b>6,090</b> | <b>153,500</b> |
| <b>Pjesëmarrja horizontale e numrit të konsumatorëve sipas kategorive në totalin e numrit të konsumatorëve</b> |    |               |               |              |              |              |               |               |              |                |
| Amvisëria                                                                                                      | %  | 56.39%        | 15.44%        | 4.08%        | 2.68%        | 2.48%        | 7.17%         | 7.87%         | 3.89%        | <b>100%</b>    |
| Bizneset e vogla                                                                                               | %  | 66.62%        | 9.74%         | 2.36%        | 1.48%        | 2.11%        | 4.92%         | 7.85%         | 4.92%        | <b>100%</b>    |
| Bizneset e mëdha                                                                                               | %  | 71.59%        | 4.06%         | 4.76%        | 4.76%        | 1.33%        | 9.59%         | 2.31%         | 1.61%        | <b>100%</b>    |
| Institucionet                                                                                                  | %  | 58.16%        | 6.32%         | 5.29%        | 4.25%        | 4.83%        | 8.16%         | 8.85%         | 4.14%        | <b>100%</b>    |
| <b>Total me mesatare</b>                                                                                       | %  | <b>63.19%</b> | <b>8.89%</b>  | <b>4.13%</b> | <b>3.29%</b> | <b>2.69%</b> | <b>7.46%</b>  | <b>6.72%</b>  | <b>3.64%</b> | <b>100%</b>    |
| <b>Pjesëmarrja vertikale e numrit të konsumatorëve sipas kategorive në totalin e numrit të konsumatorëve</b>   |    |               |               |              |              |              |               |               |              |                |
| Amvisëria                                                                                                      | %  | 86.89%        | 93.00%        | 92.18%       | 91.71%       | 89.89%       | 91.12%        | 89.23%        | 86.84%       | <b>90.11%</b>  |
| Bizneset e vogla                                                                                               | %  | 11.36%        | 6.49%         | 5.91%        | 5.62%        | 8.47%        | 6.92%         | 9.84%         | 12.18%       | <b>8.35%</b>   |
| Bizneset e mëdha                                                                                               | %  | 1.17%         | 0.26%         | 1.14%        | 1.73%        | 0.51%        | 1.29%         | 0.28%         | 0.38%        | <b>0.85%</b>   |
| Institucionet                                                                                                  | %  | 0.58%         | 0.25%         | 0.77%        | 0.94%        | 1.13%        | 0.67%         | 0.65%         | 0.60%        | <b>0.70%</b>   |
| <b>Total</b>                                                                                                   | %  | <b>100%</b>   | <b>100%</b>   | <b>100%</b>  | <b>100%</b>  | <b>100%</b>  | <b>100%</b>   | <b>100%</b>   | <b>100%</b>  | <b>100%</b>    |


#### 4.1 Zona e Shërbimit

Zona në të cilën KRU “Prishtina” Sh.A., ofron shërbime të ujit të pijes dhe largimit të ujërave të ndotura shtrihet në tetë (8) komuna të Kosovës Qendrore, dhe në një komunë tjetër (Vushtrri) që kryen shërbime vetëm në dy fshatra në kufi me komunën e Obiliqit. Komunat që pranojnë shërbime janë:

- Prishtina
- Fushë Kosova
- Obiliq
- Graçanica
- Shtimja
- Lipjani
- Podujeva dhe
- Drenasi

Mbulueshmëria me shërbime të ujit dhe kanalizimit e inkorporuar në hartën e Republikës së Kosovës është paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Kjo zonë është përkufizuar me ngjyrën e kuqe dhe përmban në vete tetë (8) komunat të përqendruara në Kosovën Qendrore:

**Grafikoni nr. 1. Harta e mbulueshmërisë**



#### 4.2 Burimet e ujit të KRU “PRISHTINA” Sh.A.

KRU “PRISHTINA” Sh.A. ka një sistem shumë të ndërlikuar për përpunimin dhe shpërndarjen të ujit për pije. Uji i pa përpunuar merret nga liqenet akumuluese dhe burimet nëntokësore - pusët. Sasia e përgjithshme e ujit të përpunuar, e vënë në dispozicion të konsumatorëve brenda sistemit të KRU “Prishtina” Sh.A. pompohet minimalisht një herë dhe maksimalisht 6 herë për të arritur tek konsumatori. Prandaj si rezultat, kostoja e trajtimit dhe shpërndarjes është mund të jetë e lartë (konsumi i madh i energjisë elektrike, kemikateve dhe amortizimi i pompave dhe elektromotorëve nga puna e pandërprerë).

#### 4.2.1 Impianti i Trajtimit të Ujit për Pije – Shajkovc

Impianti i Trajtimit të Ujit për Pije në fshatin Shajkovc, ujin e papërpunuar e merr në liqenin artificial akumulues në fshatin Batllavë. Sipërfaqja e akumulimit në kuotën e kapërderdhjes është  $S = 2,69 \text{ km}^2$ . Sasia bruto e ujit të akumuluar në kuotën e kapërderdhjes është  $V = 38.000.000 \text{ m}^3$ .

#### 4.2.2 Impianti i Trajtimit të Ujit për Pije – Badovc

Impianti i Trajtimit të Ujit për Pije në Badovc, ujin e papërpunuar e merr në liqenin artificial akumulues me të njëjtin emër. Sipërfaqja e akumulimit në kuotën e kapërderdhjes është  $S = 1,16 \text{ km}^2$ . Sasia bruto e ujit të akumuluar kuotën e kapërderdhjes është  $V = 27.000.000 \text{ m}^3$ .

#### 4.2.3 Impianti i Trajtimit të Ujit për Pije – Shkabaj

Kapaciteti i instaluar i përpunimit të ujit është  $Q=700 \text{ l/s}$ .

Uji i pa përpunuar për këtë Impiant merret në liqenin artificial akumulues në Gazivodë (Ujman). Sasia bruto e ujit të akumuluar në këtë liqe atëherë kur niveli i ujit arrin në kuotën maksimale është  $V = 350.000.000 \text{ m}^3$ .

Në tabelën e paraqitur në vijim është shpjeguar në hollësi se si është planifikuar të kemi indeksin e trajtimit, distribuimit të ujit të pijes gjatë periudhës përkatëse të Planit të biznesit duke i specifikuar sipas Njësive Operative.

**Tabela nr. 2 Sasia e ujit të prodhuar, të faturuar/i pa faturuar sipas konsumatorëve në NJOU – 2022**

| Kategoria e konsumit           | Prishtina  | Fushë Kosova | Obiliqi   | Graçanica | Shtime  | Lipjani   | Podujeva  | Drenasi   | Totali     |
|--------------------------------|------------|--------------|-----------|-----------|---------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Trajtimi $\text{m}^3$          | 34,480,139 | 4,677,310    | 2,495,444 | 1,492,156 | 807,700 | 1,939,300 | 3,478,049 | 1,464,725 | 50,834,822 |
| Faturimi $\text{m}^3$          | 17,876,084 | 2,425,781    | 1,218,324 | 728,427   | 508,083 | 1,005,294 | 1,801,882 | 700,578   | 26,264,453 |
| Uji i pa faturuar $\text{m}^3$ | 16,604,054 | 2,251,529    | 1,277,121 | 763,729   | 299,617 | 934,006   | 1,676,166 | 764,147   | 24,570,369 |
| Trajtimi %                     | 67.83%     | 9.20%        | 4.91%     | 2.94%     | 1.59%   | 3.81%     | 6.84%     | 2.88%     | 100.00%    |
| Faturimi %                     | 35.17%     | 4.77%        | 2.40%     | 1.43%     | 1.00%   | 1.98%     | 3.54%     | 1.38%     | 51.67%     |
| Uji i pa faturuar %            | 32.66%     | 4.43%        | 2.51%     | 1.50%     | 0.59%   | 1.84%     | 3.30%     | 1.50%     | 48.33%     |

#### 4.2.4 Stacioni për përpunimin e ujit në Drenas

Stacioni për përpunim të ujit në Bivolak ka kapacitet prej  $Q=60 \text{ l/s}$ . Uji i papërpunuar merret nga kanali i hapur që shërben për ujitje e që ndodhet në Bivolak, burimi është nga Liqeni akumulues artificial në Gazivodë.

#### 4.2.5 Stacionet për pompimin dhe përpunimin e ujit

Në KRU "Prishtina" Sh.A. ekzistojnë edhe këto stacione të përpunimit dhe pompimit të ujit të pijes:

- Stacioni i pompimit Kroni, kapaciteti  $Q=50 \text{ l/s}$ .
- Stacioni i pompimit Kastrioti, kapaciteti  $Q=20 \text{ l/s}$ .
- Stacioni i pompimit Shtime, kapaciteti  $Q=40 \text{ l/s}$ .
- Stacioni i pompimit Lipjani, kapaciteti  $Q=80 \text{ l/s}$ .
- Stacioni i pompimit Podujeva, kapaciteti  $Q=18 \text{ l/s}$ .
- Stacioni i pompimit Vragoli, kapaciteti  $Q=20 \text{ l/s}$ .

### 4.3 Rrjeti shpërndarës i ujit të pijes

Infrastruktura e furnizimit me ujë të pijes është shumë e ndërthurur. Në shumicën e rasteve bashkë me rrjetin e ujit shkon paralelisht edhe rrjeti i ujërave të ndotura, duke respektuar standardet minimale që përcaktohen me rregullativën e furnizimit me ujë të pijes.

Rrjeti i shpërndarjes së ujit të pijshëm përbëhet nga këto nivele - kategori

- Rrjeti primar i shpërndarjes së ujit në gjatësi prej L=1.490 km
- Rrjeti dytësor i shpërndarjes në gjatësi prej L=710 km
- Depozite (rezervuare) me vëllim V= 80.000 m<sup>3</sup>

Tabela në vazhdim specifikon në formë tabelare indeksin e faturimit në m<sup>3</sup> bazuar në kategoritë e konsumatorëve si dhe nga aspekti i shpërndarjes në Njësi Operative.

**Tabela nr. 3 Sasia e ujit të pijes të faturuar m<sup>3</sup> sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU**

| Kategoria e konsumit                                                                   |                      | Prishtina         | Fushë Kosova     | Obiliqi          | Graçanica      | Shtime         | Lipjani          | Podujeva         | Drenasi        | Totali            |
|----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|-------------------|------------------|------------------|----------------|----------------|------------------|------------------|----------------|-------------------|
| Uji i konsumuar në amvisëri                                                            | m <sup>3</sup>       | 14,154,416        | 2,232,050        | 860,181          | 581,889        | 427,524        | 711,658          | 1,631,913        | 559,068        | <b>21,158,699</b> |
| Uji i konsumuar në BV                                                                  | m <sup>3</sup>       | 1,019,608         | 128,225          | 36,894           | 45,886         | 24,034         | 57,323           | 59,799           | 51,155         | <b>1,422,924</b>  |
| Uji i konsumuar në BM                                                                  | m <sup>3</sup>       | 642,976           | 19,505           | 289,628          | 70,362         | 665            | 71,840           | 14,039           | 6,903          | <b>1,115,919</b>  |
| Uji i Konsumuar në institucione                                                        | m <sup>3</sup>       | 2,059,083         | 46,001           | 31,621           | 30,289         | 55,859         | 164,474          | 96,131           | 83,452         | <b>2,566,911</b>  |
| <b>Totali i ujit të pijes të konsumuar</b>                                             | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>17,876,084</b> | <b>2,425,781</b> | <b>1,218,324</b> | <b>728,427</b> | <b>508,083</b> | <b>1,005,294</b> | <b>1,801,882</b> | <b>700,578</b> | <b>26,264,453</b> |
| <b>Struktura e ujit të pijes të faturuar sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU</b> |                      |                   |                  |                  |                |                |                  |                  |                |                   |
| Uji i konsumuar në amvisëri                                                            | %                    | 79.18%            | 92.01%           | 70.60%           | 79.88%         | 84.14%         | 70.79%           | 90.57%           | 79.80%         | <b>80.56%</b>     |
| Uji i konsumuar në BV                                                                  | %                    | 5.70%             | 5.29%            | 3.03%            | 6.30%          | 4.73%          | 5.70%            | 3.32%            | 7.30%          | <b>5.42%</b>      |
| Uji i konsumuar në BM                                                                  | %                    | 3.60%             | 0.80%            | 23.77%           | 9.66%          | 0.13%          | 7.15%            | 0.78%            | 0.99%          | <b>4.25%</b>      |
| Uji i Konsumuar në institucione                                                        | %                    | 11.52%            | 1.90%            | 2.60%            | 4.16%          | 10.99%         | 16.36%           | 5.34%            | 11.91%         | <b>9.77%</b>      |
| <b>Totali</b>                                                                          | <b>%</b>             | <b>100.00%</b>    | <b>100.00%</b>   | <b>100.00%</b>   | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b>   | <b>100.00%</b>   | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b>    |


Tabela në vazhdim specifikon në formë grafike indeksin e faturimit në m<sup>3</sup> bazuar në kategoritë e konsumatorëve si dhe nga aspekti i shpërndarjes në Njësi Operative.

**Tabela nr. 4 Sasia e ujit të prodhuar, të faturuar / I pa faturuar sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU - M<sup>3</sup>**

| Kategoria e konsumit             | Prishtina  | Fushë Kosova | Obiliqi   | Graçanica | Shtime  | Lipjani   | Podujeva  | Drenasi   | Totali            |
|----------------------------------|------------|--------------|-----------|-----------|---------|-----------|-----------|-----------|-------------------|
| Trajtimi m <sup>3</sup>          | 34,480,139 | 4,677,310    | 2,495,444 | 1,492,156 | 807,700 | 1,939,300 | 3,478,049 | 1,464,725 | <b>50,834,822</b> |
| Faturimi m <sup>3</sup>          | 17,876,084 | 2,425,781    | 1,218,324 | 728,427   | 508,083 | 1,005,294 | 1,801,882 | 700,578   | <b>26,264,453</b> |
| Uji i pa faturuar m <sup>3</sup> | 16,604,054 | 2,251,529    | 1,277,121 | 763,729   | 299,617 | 934,006   | 1,676,166 | 764,147   | <b>24,570,369</b> |
| Trajtimi m <sup>3</sup>          | 67.83%     | 9.20%        | 4.91%     | 2.94%     | 1.59%   | 3.81%     | 6.84%     | 2.88%     | <b>100.00%</b>    |

|                                  |        |       |       |       |       |       |       |       |               |
|----------------------------------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|---------------|
| Faturimi m <sup>3</sup>          | 35.17% | 4.77% | 2.40% | 1.43% | 1.00% | 1.98% | 3.54% | 1.38% | <b>51.67%</b> |
| Uji i pa faturuar m <sup>3</sup> | 32.66% | 4.43% | 2.51% | 1.50% | 0.59% | 1.84% | 3.30% | 1.50% | <b>48.33%</b> |

**Grafikoni nr. 2. Sasia e ujit të trajtuar, faturuar dhe pa faturuar sipas kategorive**




Problemi themelor që rëndon afarizmin e rregullt të kompanisë është përcaktuar sasia e ujit që humbet qoftë si humbje teknike apo si humbje komerciale në kuadër të KRU "Prishtina" Sh.A.

**Tabela nr. 5 Sasia e ujit të faturuar m³ sipas kategorisë së konsumatorëve në KUR "Prishtina" Sh.A., planifikuar për vitin 2022 në mijë euro**

| Elementet                         |                      | Janar        | Shkurt       | Mars         | Prill        | Maj          | Qershor      | Korrik       | Gusht        | Shtator      | Tetor        | Nëntor       | Dhjetor      | Total         |
|-----------------------------------|----------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| Uji i konsumuar nga amvisëria     | m <sup>3</sup>       | 1,702        | 1,483        | 1,677        | 1,633        | 1,710        | 1,727        | 1,931        | 2,013        | 1,841        | 1,794        | 1,746        | 1,894        | <b>21,158</b> |
| Uji i konsumuar nga BV            | m <sup>3</sup>       | 114          | 99           | 112          | 109          | 114          | 116          | 130          | 136          | 124          | 120          | 117          | 127          | <b>1,422</b>  |
| Uji i konsumuar nga BM            | m <sup>3</sup>       | 89           | 78           | 88           | 86           | 90           | 91           | 101          | 105          | 96           | 95           | 92           | 99           | <b>1,115</b>  |
| Uji i konsumuar nga institucionet | m <sup>3</sup>       | 207          | 177          | 203          | 197          | 206          | 209          | 236          | 247          | 224          | 216          | 209          | 229          | <b>2,566</b>  |
| <b>Totali i ujit të faturuar</b>  | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>2,114</b> | <b>1,838</b> | <b>2,082</b> | <b>2,027</b> | <b>2,123</b> | <b>2,144</b> | <b>2,400</b> | <b>2,502</b> | <b>2,286</b> | <b>2,226</b> | <b>2,166</b> | <b>2,350</b> | <b>26,264</b> |

Prandaj në grafikonin në vazhdim është paraqitur trendi mujor i sasisë së ujit të përpunuar dhe sasisë së ujit të adresuar tek konsumatorët përmes faturave mujore të shërbimit.

Grafikoni nr. 3. Sasia e ujit të pijes së faturuar m<sup>3</sup> sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU



Gjithashtu në të njëjtin grafikon janë inkorporuar si përqindje edhe sasia e ujit që pritet të faturohet në baza mujore nga njëra anë si dhe sasia e ujit që pritet të humbet nga ana tjetër. Sasia e përgjithshme e ujit të trajtuar përkatësisht e ujit të faturuar nuk sjell njëkohësisht edhe të ardhura nga shërbimi i ujërave të ndotura për arsye se shumë nga lokalitetet (fshatrat) posedojnë rrjetin e furnizimit me ujë ndërkaj të njëjtat nuk kanë rrjetë të organizuar të kanalizimit. Mbi këtë fakt kompania nuk ka obligim mirëmbajtjen e të njëjtave në rast të paraqitjes së nevojave për këto lokalitete.

#### 4.4 Rrjeti shpërndarës i ujërave të ndotura

KRU "Prishtina" Sh.A., në të gjithë zonën e shërbimit - ka në menaxhim  $L=1.350$  km të rrjetit të largimit të ujërave të ndotura, me dimensione dhe materiale të ndryshme. Në të shumtën e rasteve ky rrjet është i përzier edhe me kanalizimin e ujërave atmosferike. Kompania përmes personelit, mekanizmit dhe pajisjeve teknike që posedon, bën: pastrimin, deblokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në zonën e shërbimit të të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera në kolektorë.

Trajtimi i ujërave të ndotura bëhet duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ të MMPH me nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor. Udhëzimi përcakton kriteret e përgjithshme për shkarkimin e ujërave të ndotura, cakton parametrat fiziko-kimik dhe atyre bakteriologjik. Menaxhojmë me dy impiante të trajtimit të ujërave të ndotura.

##### 4.4.1 Impianti për trajtimit e ujërave të ndotura në Harilaq

Gypi prurës i kanalizimit fekal është i profilit 250 mm deri te impianti biologjik. Impianti përbëhet nga një SBR reaktor (*Sequencing Batch Reactors*). Procesi i trajtimit kontrollonhet përmes kompjuterëve industrial dhe uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor.

- Kapaciteti i Impiantit është 1230 PE (banor ekuivalent),
- Mesatarja ditore i ujërave të ndotur në hyrje  $Q_{24} = 147,6 \text{ m}^3/\text{dite} = 1,71 \text{ l/s}$
- Maksimumi ditore i ujërave të ndotur në hyrje  $Q_d = 206,64 \text{ m}^3/\text{dite} = 2,39 \text{ l/s}$
- Maksimumi ore i ujërave të ndotur në hyrje  $Q_h = 450,475 \text{ m}^3/\text{h} = 5,21 \text{ l/s}$

#### 4.4.2 Impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura në Mramor (Badovc)

Gypi prurës në Impiant është 150 mm.

Impianti përbëhet nga dy SBR reaktor (*Sequencing Batch Reactors*). Procesi i trajtimit kontrollohet përmes kompjuterëve industrial, uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor.

Kapaciteti i Impiantit është 2400 PE (banor ekuivalent),

#### 4.4.3 Impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura në (Medvec-Vrellë)- Lipjan

Gypi prurës në Impiant është D=400 mm.

Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura në Vrellë është impiant me trajtim biologjik që përbëhet nga tre SBR reaktor (*Sequencing Batch Reactors*). Procesi i trajtimit kontrollohet përmes sistemit SCADA, uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor. Impianti pritet të merret në menaxhim nga fillimi i muajit nëntor 2021

Kapaciteti i Impiantit është 3047 PE (banor ekuivalent),

Maksimumi ditore i ujërave të ndotur Qd = 1950 m<sup>3</sup>/dite = 22,4 l/s

Mesatarja ditore i ujërave të ndotur Q24 = 750 m<sup>3</sup>/dite = 12,7 l/s

#### 4.4.4 Impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura në Orllan - Podujevë

Gypi prurës në Impiant është D= 200 mm.

Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura në fshatin Orllan është impiant biologjik me Filtër Rrotullues. Procesi i trajtimit kontrollohet përmes sistemit SCADA, uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor.

Kapaciteti i Impiantit është 880 PE (banor ekuivalent),

Maksimumi ditore i ujërave të ndotur Qd = 400 m<sup>3</sup>/dite = 4.6 l/s

Mesatarja ditore i ujërave të ndotur Q24 = 340 m<sup>3</sup>/dite = 3.9 l/s

Impianti është në fazën e finalizimit të ndërtimit, që është bashkëfinancim nga Qeveria Zvicrane dhe Qeveria e Kosovës.

**Tabela nr. 6 Sasia e ujit të përdorur të faturuar sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU - 2022**


| Kategoria e konsumit                          |                      | Prishtina         | Fushë Kosova     | Obiliqi        | Graçanica      | Shtime         | Lipjani        | Podujeva       | Drenasi        | Totali            |
|-----------------------------------------------|----------------------|-------------------|------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|-------------------|
| Uji i konsumuar në amvisëri                   | m <sup>3</sup>       | 13,397,165        | 2,166,392        | 624,389        | 546,314        | 393,293        | 631,320        | 834,446        | 326,097        | <b>18,919,416</b> |
| Uji i konsumuar në BV                         | m <sup>3</sup>       | 1,020,102         | 129,570          | 36,406         | 45,014         | 23,638         | 48,738         | 56,285         | 30,627         | <b>1,390,380</b>  |
| Uji i konsumuar në BM                         | m <sup>3</sup>       | 649,219           | 19,710           | 291,819        | 71,100         | 672            | 36,313         | 14,187         | 2,820          | <b>1,085,838</b>  |
| Uji i Konsumuar në institucione               | m <sup>3</sup>       | 2,072,886         | 45,974           | 21,285         | 30,607         | 56,445         | 158,022        | 29,486         | 39,871         | <b>2,454,576</b>  |
| <b>Totali i ujit të përdorur të konsumuar</b> | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>17,139,372</b> | <b>2,361,645</b> | <b>973,899</b> | <b>693,034</b> | <b>474,048</b> | <b>874,393</b> | <b>934,404</b> | <b>399,415</b> | <b>23,850,210</b> |

**Struktura e ujit të përdorur të faturuar sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU**

|                                 |   |                |                |                |                |                |                |                |                |                |
|---------------------------------|---|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Uji i konsumuar në amvisëri     | % | 78.17%         | 91.73%         | 64.11%         | 78.83%         | 82.96%         | 72.20%         | 89.30%         | 81.64%         | <b>79.33%</b>  |
| Uji i konsumuar në BV           | % | 5.95%          | 5.49%          | 3.74%          | 6.50%          | 4.99%          | 5.57%          | 6.02%          | 7.67%          | <b>5.83%</b>   |
| Uji i konsumuar në BM           | % | 3.79%          | 0.83%          | 29.96%         | 10.26%         | 0.14%          | 4.15%          | 1.52%          | 0.71%          | <b>4.55%</b>   |
| Uji i Konsumuar në institucione | % | 12.09%         | 1.95%          | 2.19%          | 4.42%          | 11.91%         | 18.07%         | 3.16%          | 9.98%          | <b>10.29%</b>  |
| <b>Totali</b>                   | % | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> | <b>100.00%</b> |

Në grafikonin e radhës janë paraqitur struktura e Njësive operative të ujësjellësve në totalin e sasisë së ujit të përpunuar dhe të shpërndarë në rrjetin primar dhe sekondar të shpërndarjes.

**Grafikoni nr. 4. Sasia e ujit të përdorur të faturuar në m<sup>3</sup> sipas kategorisë së konsumatorëve në NJOU-ve**




**Faturimi i ujërave të ndotura** bëhet në pajtim me Urdhëresën tarifore të ARRU-së. Në vitin 2022 sasia e ujërave të ndotura që planifikohet se do të faturohen për konsumatorët është 23.576.020 m<sup>3</sup> nga sasia e përgjithshme e ujit të faturuar. Kjo sasi sipas konsumatorëve në baza vjetore duket sipas tabelës së radhës:

**Tabela nr.7 Sasia e ujit të përdorur të faturuar sipas kategorisë së konsumatorëve në KUR "Prishtina" sh.a.- 2022, në mijëra euro**

| Elementet                        |                      | Janar        | Shkurt       | Mars         | Prill        | Maj          | Qershor      | Korrik       | Gusht        | Shtator      | Tetor        | Nëntor       | Dhjetor      | Total         |
|----------------------------------|----------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| Uji - amvisëri                   | m <sup>3</sup>       | 1,522        | 1,319        | 1,497        | 1,458        | 1,527        | 1,545        | 1,732        | 1,808        | 1,649        | 1,602        | 1,559        | 1,694        | 18,919        |
| Uji – BV                         | m <sup>3</sup>       | 112          | 96           | 110          | 107          | 112          | 113          | 127          | 133          | 121          | 117          | 114          | 124          | 1,390         |
| Uji – BM                         | m <sup>3</sup>       | 87           | 76           | 86           | 84           | 88           | 88           | 98           | 102          | 94           | 92           | 89           | 97           | 1,085         |
| Uji- institucione                | m <sup>3</sup>       | 198          | 169          | 194          | 188          | 197          | 200          | 227          | 237          | 214          | 206          | 200          | 219          | 2,454         |
| <b>Totali i ujit të faturuar</b> | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>1,921</b> | <b>1,661</b> | <b>1,888</b> | <b>1,838</b> | <b>1,926</b> | <b>1,947</b> | <b>2,185</b> | <b>2,281</b> | <b>2,079</b> | <b>2,019</b> | <b>1,964</b> | <b>2,135</b> | <b>23,850</b> |

Paraqitja grafike e strukturës së sasisë së ujit të faturuar sipas Urdhëresës tarifore për shërbimin e kanalizimit është paraqitur si më poshtë:

**Grafikoni nr. 5 Sasia e ujit të përdorur të faturuar sipas kategorisë së konsumatorëve në KUR Prishtina Sh.a**



## 5. TARIFA E SHËRBIMIT

Kompania zbaton tarifën që e vendos Autoriteti Rregullativ i Ujërave, i cili është kompetent në bazë të Ligjit mbi veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit kanalizimit dhe të mbeturinave (Ligji nr. 03/L-086).

Menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit "Prishtina" Sh.A. në zbatim të afateve kohore të përcaktuara nga ana e ARRU-së, pasi paraprakisht ka marrë autorizimin e nevojshëm nga ana e Bordit të Drejtorëve ka përgatitur dokumentacionin për aplikim për Tarifën që do të zbatohet në vitin 2022-2024. Përmes kërkesës numër 38/DT me datë 03.02.2021 të njëjtat i ka dorëzuar në ARRU për trajtim të mëtutjeshëm (afati ligjor i nxjerrjes së Urdhëresës tarifore përcaktohet deri 31.12.2021)

Në bazë të Politikës tarifore në zbatim, mundësohet financimi në tërësi vetëm i kostove operative dhe mirëmbajtjes dhe jo mjaftueshëm për investime kapitale.

Autoriteti Rregullativ i Ujërave, me procesin e fundit tarifar (për vitin 2021) ka përcaktuar një tarifë të njëjtë të shërbimeve të ujit me vitin paraprak (2020), sipas së cilit për sektorin e amvisërisë ka pasur një rritje fare të vogël të tarifës volumetrike, ndërsa për konsumatorë e jo-amvisërisë një tarifë më të ulët. Kjo ka shkaktuar rënie të tarifës mesatare në kuadër të kompanisë.

Vazhdimi i një trendi të njëjtë duke zbritur tarifën për jo-amvisëri dhe duke mbajtur të njëjtë tarifën për amvisëri do të shkaktojë mungesë së të ardhurave nën parakushtet e mbetjes në nivelin e njëjtë të treguesve tjerë të përformacës (rritja e sasisë së ujit të faturuar etj.).

Aktualisht ARRU është në proces të përcaktimit të Tarifës së shërbimit për periudhën 2022 - 2024.

Kompania ka shprehur qëndrimin se: trendi i përafrimit të koeficientit të ndër subvencionimit ndërmjet kategorive të konsumatorëve të shtyhen në një periudhë tjetër kohore. Këtë e mbështesim edhe në faktin se ARRU përmes përcaktimit të tarifave të shërbimit për procesin tarifar 2018 - 2020 ka bërë ndërrimin e qasjes së përcaktimit të tarifave duke shkuar në drejtim që në procesin e ardhshëm tarifar 2022 - 2024 tarifën në të gjitha kategoritë e konsumatorëve të jenë të njëjta. Pra në vitin 2018 ka filluar që koeficienti i ndër financimit të zvogëlohet:

- Raporti i nder financimit tarifar në vitin 2017 2,25
- Raporti i nder financimit tarifar në vitin 2018 2,04
- Raporti i nder financimit tarifar në vitin 2019 1,83
- Raporti i nder financimit tarifar në vitin 2020 1,67
- Raporti i nder financimit tarifar në vitin 2021 1.67
- Raporti i nder financimit tarifar në vitin 2022 ?

### 5.1 Tarifat e shërbimit për vitin 2021 (në kuadër të këtyre tarifave është ndërtuar Plani i biznesit 2022)

**Tabela nr. 8** Tarifat fikse dhe Tarifat volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

| Kategoria e konsumatorëve                 | Tarifa Fikse (EUR/muaj) | Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujësjellësit (EUR/m <sup>3</sup> ) | Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujërave të ndotura (EUR/m <sup>3</sup> ) |
|-------------------------------------------|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| Shtëpiak                                  | 1                       | 0.43                                                                  | 0.05                                                                        |
| Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 2                       | 0.69                                                                  | 0.11                                                                        |

### 5.2 Tarifat për aktivitetet themelore të lidhjes së konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

**Tabela nr.9** Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës/grumbullues dhe ujëmatësve | 10.00                                     |

#### Shënim:

1. Pasi që kjo tarifë përfshinë kryesisht shpenzime fikse, atëherë e njëjta shumë (d.m.th 10 EUR) do të paguhet kur inspektimi: (i) për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, kur ekzistojnë të dyja bashkë; dhe (ii) kur ekziston kërkesa vetëm për njërin shërbim.
2. Kjo tarifë nuk aplikohet kur lidhja e re realizohet nga Kompania, me ç'rast duhet të aplikohet vetëm tarifa: "Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit".
3. Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur lidhja e re realizohet nga kompanitë e autorizuara përmes donacioneve, pasi që tërë projekti (përfshirë edhe lidhjet) i nënshtrohen pranimit teknik.

**Tabela nr. 10** Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR) | Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR) | Tarifa totale (lidhja, pusëta, asfaltimi)*** (EUR) |
|--------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 15 mm                       | 80.00                               | 240.00                                            | 490.00                                             |
|                                                        | 20 mm                       | 80.00                               | 240.00                                            | 490.00                                             |
|                                                        | 25 mm                       | 100.00                              | 260.00                                            | 510.00                                             |
|                                                        | 32 mm                       | 140.00                              | 300.00                                            | 550.00                                             |
|                                                        | 40 mm                       | 180.00                              | 340.00                                            | 590.00                                             |

|  |            |        |        |          |
|--|------------|--------|--------|----------|
|  | 50 mm      | 370.00 | 530.00 | 780.00   |
|  | 65 & 75 mm | 490.00 | 650.00 | 900.00   |
|  | 80 mm      | 625.00 | 785.00 | 1,035.00 |
|  | 100 mm     | 780.00 | 940.00 | 1,190.00 |

**Shënim:**

\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

\*\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

\*\*\*Aplikohet në rastet kur gypi i shërbimit gjendet në rrugë apo trotuar kur kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

**Tabela nr. 11 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit**

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR) | Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR) | Tarifa totale (lidhja, puseta, asfaltimi)*** (EUR) |
|--------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 160 mm                      | 26.00                               | 153.00                                            | 403.00                                             |
|                                                        | 200 mm                      | 36.00                               | 163.00                                            | 413.00                                             |
|                                                        | 250 mm                      | 46.00                               | 173.00                                            | 423.00                                             |
|                                                        | 315 mm                      | 76.00                               | 203.00                                            | 453.00                                             |

**Shënim:**

\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

\*\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

\*\*\*Aplikohet në rastet kur puseta gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

**Tabela nr. 12 Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit**

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës/grumbullues dhe ujëmatësve | 10.00                                     |

**Tabela nr. 13 Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit**

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës/grumbullues dhe ujëmatësve | 20.00                                     |

**Tabela nr. 14 Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme)**

| Kategoria e konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|---------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------|
|---------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------|

|                                                        |                                                                           |       |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës/grumbullues dhe ujëmatësve | 10.00 |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------|

### 5.3 Tarifat për aktivitetet tjera themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

**Tabela nr. 15** Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i ujëmatësit | Tarifa për ujësjellës (EUR) |
|--------------------------------------------------------|-----------------------|-----------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 20 mm                 | 16.50                       |
|                                                        | 25 mm                 | 16.50                       |
|                                                        | 32 mm                 | 16.50                       |
|                                                        | 40 mm                 | 18.00                       |
|                                                        | 50 mm                 | 18.00                       |
|                                                        | 63 mm                 | 18.00                       |
|                                                        | 75 mm                 | 19.00                       |
|                                                        | 90 mm                 | 19.00                       |
|                                                        | 110 mm                | 19.00                       |

**Shënim:** Kjo tarifë aplikohet konform nenit 28 të Rregullores 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

## 6. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KRU “PRISHTINA” Sh.A.- PERIUDHA 2022– 2024

Deklarata e vizionit dhe deklarata e misionit, si dhe procesi i vazhdimësisë së veprimtarisë së KRU “Prishtina” Sh.A. kërkon: përkushtim, dije, përkrahje institucionale dhe mjete të lira financiare për investime të reja drejt zhvillimit dhe përparimit tekniko-teknologjik në lëminë e përpunimit të ujit për pije dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave të ndotura, duke përfshirë edhe zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura krahas zhvillimit urbanistik dhe popullatës në zonën e shërbimit.

Konsumatorët në zonën e shërbimit aktualisht kanë një furnizim cilësor dhe sasior me ujë të pijes. Reduktimet e planifikuara janë tërhequr në tërësi, përveç në sezona të vapës dhe konsumit të lartë. Konsumatorët, në kuotat e larta, kryesisht ata në qytetin- Prishtinë, problemet e furnizimit me ujë sidomos në sezonin e verës i kanë më të theksuara.

### 6.1 Objektiva strategjike 1: Reduktimi i humbjeve të ujit (uji pa të ardhura)

Uji i humbur në rrjetin e furnizimit aktualisht paraqet shqetësimin më të madh për të tanishmen dhe ardhmërinë e kompanisë. Humbjet e teknike dhe administrative, të ujit janë rritur sidomos pas vënjes në funksion të ITUP-Shkabaj.

Kompania do të shtoj dhe avancojë të gjitha aktivitetet në mënyrë që të vejë në kontroll dhe të zvogëlojë sasinë e ujit pa të ardhura. Aktivitetet në investime kapitale dhe të mirëmbajtjes të filluara në vitet pararendëse të këtij Planit të biznesit, pritet që efektet e para do të vërehen gradualisht në vitet përgjatë funksionimit të këtij Planit

të biznesit (2022- 2024), mirëpo kufizimi i investimeve kapitale nga ARRU me qëllim të mbajtjes së tarifave paraqet sfidë të dyfishtë për kompaninë.

Rritja e sasisë së ujit të përpunuar të futur në rrjetin e shpërndarjes sidomos pas lëshimit në punë të ITUP Shkabaj, ka shkaktuar rritje të shkallës së humbjeve teknike dhe administrative të ujit përkundër faktit se kompania ka shkallë më të ulët se sa mesatarja e ujit pa të ardhura në sektorin e ujit në Republikën e Kosovës. Kompania ka nisur aktivitete shtesë për të stabilizuar këtë tregues shumë të rëndësishëm.

Gjatë vitit 2018 është miratuar Strategjia<sup>1</sup> për zvogëlimin e humbjeve të ujit në periudhën 2018-2022. Strategjia ka përcaktuar synimet, fondet dhe përgjegjësitë për të arritur deri te zvogëlimi i humbjeve të ujit në shkallën 48 %.

Bordi i Drejtorëve, shpreh ambiciet dhe inkurajon menaxhmentin që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të domosdoshme që ky objektivi i parapërcaktuar të përmbushet me qëllim që humbjet teknike dhe administrative të minimizohen. Natyrshëm, kjo do të ketë ndikimin e drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë.

### **Caku 1: Konsolidimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve**

Nënkupton identifikimi, incizimi dhe regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në të gjithë zonën e shërbimit. Aktivitete e planifikuara për arritjen e këtij synimi janë:

- Incizimi kyçjeve shtëpiake dhe ujëmatësve nga ekipet e kompanisë;
- Përditësimi sistematik i të dhënave të incizuara në terren në bazë e të dhënave të konsumatorëve nga Operatorët e SIG-it;
- Verifikimi i të gjitha rasteve (konsumatorëve) të cilat aktualisht nuk faturohen. Kompania planifikon të formojë një komision i cili do të verifikojë të gjitha rastet e konsumatorëve të cilët aktualisht nuk faturohen. Konform gjetjeve të këtij komisioni do paraqesë raportin me gjetjet në teren.

### **Caku 2: Identifikimi dhe eliminimi i lidhjeve ilegale dhe formave të tjera të shfrytëzimit të paautorizuar të ujit**

Zona në të cilën kryen shërbime KRU "Prishtina" Sh.A., është shumë dinamike sa i përket çështjes së zhvillimeve urbanistike. Numri i konsumatorëve është në rritje të vazhdueshme, prandaj po ndërmerren të gjitha aktivitetet në Departamentin e Shitjes dhe Departamentin e Konsumatorëve që me kohë të bëhet evidentimi i të gjithë konsumatorëve me qëllim të eliminimit në tërësi të kyçjeve ilegale.

Për realizimin e këtij caku, janë planifikuar këto aktivitete:

- Zbulimi dhe raportimi i lidhjeve ilegale nga lexuesit e ujëmatësve;
- Zbulimi dhe raportimi i kyçjeve ilegale nga inspektorët;
- Regjistrimi dhe faturimi i konsumatorëve të kyçur ilegalisht;
- Zbulimi dhe eliminimi i vjedhjeve të ujit (lidhjet para ujëmatësit).

Aktivitetet do të jenë të vazhdueshme.

### **Caku 3: Faturimi i konsumit faktik të ujit, instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët dhe sigurimi i saktësisë së matjes dhe leximit**

Në ndërmarrje aktualisht shkalla e matjes së konsumit të ujit është mbi 97% e totalit të konsumatorëve në sektorin e amvisërisë, që janë aktiv e marrin shërbime të ujit dhe kanalizimit. Këtë gjendje së paku e raporton softueri mbi bazë të të cilit përllogariten faturat, megjithatë kompania konsideron se saktësia e leximit të tyre nuk është në nivelin e dëshirueshëm.

<sup>1</sup> Strategjia për reduktimin e humbjeve të ujit është dokument i hartuar nga KRU-të në Kosovë së bashku me Këshillin Ndërmënor për Ujëra në Kosovë si dhe ARRU-në. Është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në vitin 2018, strategji e hartuar për 5 vite, ku janë paraparë në detaje veprimet dhe investimet konkrete sipas cazeve.

Përmbushjen e këtij caku ndërmarrja do të bëjë përmes zbatimit të këtyre aktiviteteve:

- Instalimi i ujëmatësve të rinj për zëvendësimin e ujëmatësve jofunksional;
- Kontrollimi sistematik i saktësisë së leximit të ujëmatësve;
- Inicimi i procesit të leximit të ujëmatësve nga distanca;
- Bllombimi i të gjithë ujëmatësve etj.

#### **Caku 4: Krijimi i sistemit efektiv për identifikimin dhe riparimin e shpejtë të rrjedhjeve të dukshme**

Sistemi efektiv nënkupton një organizim përmes të cilët koha e nevojshme për riparimin e një rrjedhe të dukshme të ujit është fare minimale. Kjo mund të realizohet duke ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- Aplikimi i skemës stimuluese për raportimin e rrjedhjeve të ujit përfshirë qytetarët apo edhe personelin e kompanisë;
- Vendosja e standardit për riparim brenda 24 orëve të rrjedhjeve të raportuara;
- Ngritja e cilësisë së materialeve të përdorura gjatë riparimeve dhe zgjerimit të rrjetës së furnizimit.

#### **Caku 5: Detektimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme-nëntokësore**

Aktivitetet që do të ndërmerren për të përmbushur këtë cak janë listuar në vijim:

- Ndarja e zonës së shërbimit në nën-zona - një për secilën prej 4 ekipeve;
- Kontrollimi sistematik i rrjetit me qëllim të zbulimit të rrjedhjeve nëntokësore;
- Vendosja e standardit për riparimin brenda 7 ditëve të të gjitha rrjedhjeve të raportuara.

#### **Caku 6: Zëvendësimi i infrastrukturës së vjetërsuar të ujësjellësit (rrjetit shpërndarës dhe kyçjeve shtëpiake)**

Aktivitete e planifikuara:

- Rehabilitimi/zëvendësimi i kyçjeve shtëpiake në periudhën 2022-2024;
- Rehabilitimi/zëvendësimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit bazuar në planin e menaxhimit të aseteve dhe kriteret e shërbyeshmërisë së rrjetit. Gjatë viteve 2022 - 2024 do të zëvendësojë 4,000 metra rrjetë të ujësjellësit në pjesët e ndryshme.

#### **Caku 7: Krijimi i zonave të matura (DMA-ve) për menaxhim e humbjeve të ujit**

- Definimi i zonave të matura (DMA) , aktualisht është në përfundim të procesit të definimit të zonave të matura. Madhësia e DMA-ve do të përcaktohet konform udhëzimeve të IWA-së për madhësinë optimale të DMA-ve (rreth 2000-3000 kyçje);
- Monitorimi i ujit të pa faturuar në kuadër të DMA-ve dhe përcaktimi i saktë i bilancit uJOR.

#### **Caku 8: Menaxhimi i presioneve**

Aktivitetet:

- Rishikimi dhe ridefinimi i zonave të presionit, tash për tash në zonën e shërbimit ka nën zona ku presionet janë jashtëzakonisht të larta (mbi 7 bar). Presionet e larta i rrisin humbjet e ujit. Rishikimi i zonave të presionit me qëllim të optimizimit të presioneve dhe menaxhimit të tyre, për të mbajtur presionet në rrjet prej 2-4 bar;
- Funkcionalizimi i zonave të reja të presionit përmes punëve teknike operative (instalimi i pajisjeve për reduktimin e presionit për zonat e ridefinuara).

## **6.2 Objektiva strategjike 2: Mbledhja e borxheve të prapambetura përkatësisht zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme**

Ndërmarrja synon që për çdo vit, përveç arkëtimit të faturës së vitit, të arkëtoj diku prej 10 deri 15% të llogarive të arkëtueshme të mbledhura të ndërmarrjes ndër vite.

Për gjatë viteve të funksionimit përkatësisht përfshirë periudhën shtator 1999 - shtator 2021 në vazhdimësi (me përjashtime të vogla) vlera e faturimit të shërbimeve ka qenë më e madhe se vlera e shërbimeve që janë arkëtuar. Sidomos deri në vitin 2017, norma e shërbimeve të arkëtuara ka qenë shumë më e ulët në krahasim me gjendjen ekzistuese. Rezultatet që janë arritur si dhe tendenca në rritje e vlerës së arkëtuar ka ndikuar që rritja e borxhit të akumuluar në vitet e fundit të jetë e papërfillshme.

Në pajtim me Ligjin mbi Faljen e Borxheve Publike, është bërë falja e borxheve për 51,989 konsumatorë, ndërsa vlera e borxhit të falur është 10,420.215 €. Pavarësisht përfitimeve nga ky proces që ka pasur ndërmarrja nga njëra anë si dhe konsumatorët përfitues nga ana tjetër, një numër i madh i konsumatorëve nuk iu është përmbajtur kontratës së shërbimit.

Menaxhmenti, është në dijeni dhe do të angazhohet në mënyrë konkrete dhe përmbajtësore që të arkëtojë këtë potencial të mundshëm financiar deri në kufijtë e së mundshmes, duke bërë përpjekje që në vitin 2022 dhe 2023 të mos ketë rritje në llogaritë e arkëtueshme (apo rritje solide bazuar në situatën me pandemi gjatë kësaj periudhe), përkatësisht të shkohet në drejtim të zvogëlimit të këtij zëri bilancor.

Menaxhmenti do të bëjë përpjekje të vazhdueshme për arkëtimin e të njëjtave përmes aktiviteteve shtesë:

- Intensifikimin e dërgimit të lëndëve në përmbarim të dhunshëm përmes Përmbaruesve privat;
- Koordinim efikas të veprimeve me Agjensionin Kosovar të Privatizimit (arkëtimi i borxheve të ish ndërmarrjeve shoqërore);
- Bashkërendimi i aktiviteteve me institucionet shtetërore për arkëtimin e borxheve nga konsumatorët që janë pjesë e skemave sociale;
- Shtypja dhe dërgimi të konsumatorët borxhlinj të sektorit të amvisërisë për më shumë se 63,100 vërejtje për borxhet më të mëdha se 50 Euro me mbi 130 mijë konsumatorë të regjistruar;
- Shtypja dhe dërgimi të konsumatorët borxhlinj të sektorit të bizneseve të vogla për më shumë se 6,637 vërejtje për borxhet më të mëdha se 100 Euro nga 14,164 konsumatorë të regjistruar;
- Shtypja dhe dërgimi të konsumatorët borxhlinj të sektorit të bizneseve të mëdha për më shumë se 672 vërejtje për borxhet më të mëdha se 200 Euro nga 1,412 konsumatorë të regjistruar;
- Shtypja dhe dërgimi të konsumatorët borxhlinj të sektorit të institucioneve për më shumë se 334 vërejtje për borxhet më të mëdha se 300 Euro nga 845 konsumatorë të regjistruar (gjendja 31.07.2020);
- Shfrytëzimi i mediave publike përmes kampanjave vetëdijësuese;
- Rikujtim përmes thirrjeve telefonike dhe sms-ve për pagesat e mbetura përmes linjës telefonike për konsumatorët borxhlinj.

Mbi bazën e fakteve se kategoria e konsumatorëve të amvisërisë konsumojnë saktësisht 80 % të sasisë së ujit të faturuar, kjo na bën të konstatojmë se kjo kategori është substanciale për të ardhmen e kompanisë.

### **6.3 Objektiva strategjike 3: Rritja e mbulueshmërisë së në zonën e shërbimit - furnizimit me ujë të pijes (mbulimi i tërësishëm i zonës)**

Ndërmarrja synon që gjatë periudhës së planit të biznesit të arrijë rritjen e mbulueshmërisë prej 2% në vit. Aktualisht përqindja e mbulueshmërisë është rreth 88%, ndërsa ndërmarrja synon që në periudhë të planit të biznesit të arrihet një mbulueshmëri prej 94%.

Duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e pushtetit lokal, kompania do të bashkëpunojë me qëllim që të ofrohen shërbime kualitative për shërbime të ujit dhe ujërave të ndotura nëpër këto njësi komunale.

Fondet e mbetura (të kompanisë) për investime kapitale nga kryerja e veprimtarisë aktualisht janë të pamjaftueshme për zgjerimin e rrjetave të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, por edhe procesi

i caktimit të tarifave, nuk parasheh që zgjerimi i infrastrukturës të bëhet me fonde të ndërmarrjes. Megjithatë, zhvillimi i hovshëm i lokaliteteve në zonën e shërbimit, veçanërisht qyteti i Prishtinës dhe Fushë Kosovës gjithnjë ka nevojë për shtrirje të rrjetave dhe rritje të kapaciteteve të infrastrukturës ujore.

Arritja e objektivës së lartë cekur synohet të arrihet përmes këtyre aktiviteteve kryesore:

- Financimet nga komunat - gjatë takimeve dhe diskutime me të gjitha komunat në zonën e shërbimit, përfaqësuesit e qeverisjes lokale janë shprehur të kënaqur me arritjet e deritanishme, në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve. Në kuptimin e kësaj kompania ka ndarë buxhet rreth 250,000 € për këtë qëllim. Pushteti lokal thuajse në tërësi e konsideron të mbyllur çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm ndërkaq në rritje tendencën për zgjerimin e rrjetit të ujërave të ndotura. Aktualisht, komunat nuk kanë buxhete të specifikuara për projekte të caktuara, megjithatë kanë shfaqur gatishmërinë që në kuadër të rezervës buxhetore sipas kërkesës së KRU "Prishtina" Sh.A. dhe nevojës së komunitetit përkatës të marrin pjesë në bashkëfinancimin e çdo projekti në proporcionin 50% ujësjellësi dhe 50% komuna.
- Financimet nga donatorët (shpjegimet në vijim);
- Financimet nga komuniteti (aktualisht të panjohura);
- Kompania do të kërkojë dhe harmonizojë me komunat planet investive në rrjetin e ujit dhe ujërave të ndotura në bazë të Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2022-2024;
- Planifikimet për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura është përgjegjësi e komunave se ku planifikohen ndërtimet e reja dhe zgjerimet e kësaj infrastrukture. KRU "Prishtina" Sh.A. ka për obligim pas ndërtimit të marrë në operim dhe mirëmbajtje.

## 7. GJENDJA AKTUALE NË KRU "PRISHTINA" Sh.a.

### 7.1 Performancat financiare gjatë vitit 2021

Koha e mbetur deri në përfundim të vitit 2021, nënkupton faktin se kompania duhet të rritë përkushtimin me qëllim që të përmbushë apo në variantin më të "keq" të përmirësojë shumicën e treguesve të performancës, sidomos në ata tregues në të cilët është vërejtur një ngecje (sasia e ujit të faturuar, norma e arkëtimit ndaj - *ref. tabela 13*).

Analiza e performancës financiare sipas treguesve kryesorë, por njëkohësisht edhe të analizave tjera që lidhen me vitin aktual si dhe rezultatet krahasuese janë bërë duke marrë për bazë rezultatet faktike për periudhën janar - gusht 2021 dhe vlerave të planifikuara për periudhën shtator - dhjetor 2021 të korrigjuara me trendin që është zhvilluar në periudhën janar - gusht 2021.

Vlera totale e shitjes së shërbimeve bazë përkatësisht faturimeve të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotur përfshirë edhe të hyrat nga tarifa fikse e shërbimit, më 31.12.2021 do të jenë rreth 15,033,628 €. Ndërsa vlera e planifikuar në Planin e biznesit për vitin 2021 që ka qenë 15,741,048 €. Kjo do të thotë se Plani i biznesit do të jetë i përmbushur në shkallën 96%, përkatësisht diferencë në vlerë financiare prej 707,420 €, (kjo diferencë edhe mund të jetë më e madhe duke mos përjashtuar faktin se objektivat e periudhës shtator- dhjetor 2021 janë dukshëm më të larta në krahasim me ato që janë realizuar në periudhën janar - gusht).

Sipas Planit të biznesit ka qenë i planifikuar prodhimi dhe përpunimi i ujit në sasisinë prej 49,594,947 m<sup>3</sup>, ndërsa sasia totale e përpunuar pritet të jetë rreth 53,338,188 m<sup>3</sup> ujë. Kjo paraqet një rritje të sasisë së planifikuar për 7.5% përkatësisht (3,743,238) m<sup>3</sup>. Kjo sasi është vënë në shfrytëzim për të përmbushur nevojat e konsumatorëve pavarësisht se krejt sasia nuk ka mundur të faturohet. Ndërsa deri në fund të vitit 2021 do të arrihet të faturohet jo më shumë se 23,068,836 m<sup>3</sup>. Sasia e pritshme e faturimit është 90 % e sasisë së planifikuar për vitin përkatës gjegjësisht diferenca ndaj planit për rreth 2,526,085 m<sup>3</sup>. Mirëpo trendet e muajve të fundit tregojnë shifra rekorde nga aspekti historik i ndërmarrjes dhe kjo bënë të kuptojmë që trendi i faturimit ka një rritje progresive.

Në përfundim të vitit 2021, vlera totale e të hyrave të arkëtuara nga shërbimet bazë të pritjet të jenë 13,732,721 €. Me këtë rast e shohim të domosdoshme të theksojmë se arkëtimi i planifikuar në vlerë prej 14,829,435 € është përmbushur deri në shkallën 93 %. Kjo vlerë është -1,096,714 € më e vogël në krahasim me Planin e biznesit. Deri në fund të vitit përkatësisht për periudhën e mbetur (tetor, nëntor dhe dhjetor) me qëllim të përmirësimit të situatës financiare do të bëhet intensifikimi i të gjitha aktiviteteve që do të ndërmerren:


- Rritje e përkushtimit të menaxhmentit dhe personelit tjetër për rritjen e shkallës së arkëtimit në periudhën e mbetur e sidomos në sektorin e amvisërisë.
- Gjithashtu edhe në sektorin e bizneseve të vogla (lokalet) të intensifikohen aktivitetet për përmirësimin e shkallës së arkëtimit.

Ka vazhduar trendi i rritjes së numrit të konsumatorëve.

**Tabela nr. 16 Faturimi dhe arkëtimi mujor i shërbimeve bazë e planifikuar për vitin 2021, në mijëra euro**

| Elementet                           | € | Janar | Shkurt | Mars  | Prill | Maj   | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Total  |
|-------------------------------------|---|-------|--------|-------|-------|-------|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--------|
| Totali mujor i faturimeve           | € | 1,118 | 1,194  | 1,156 | 1,153 | 1,214 | 1,238   | 1,308  | 1,247 | 1,363   | 1,332 | 1,304  | 1,401   | 15,033 |
| Totali mujor i arkëtimit            | € | 902   | 1,178  | 1,178 | 1,064 | 889   | 1,075   | 1,134  | 1,118 | 1,302   | 1,276 | 1,252  | 1,359   | 13,732 |
| Përqindja mesatare totale arkëtimit | % | 81%   | 98%    | 101%  | 92%   | 73%   | 86%     | 87%    | 90%   | 96%     | 96%   | 97%    | 97%     | 92%    |

**Grafikoni nr. 6 Faturimi dhe arkëtimi mujor i shërbimeve bazë për vitin 2021**



## 7.2 Performanca operative në vitin 2021

Performanca e përgjithshme operative në vete përfshin:

- Kaptimin, pastrimin dhe përpunimin e ujit të pijes;
- Shpërndarjen e ujit;
- Mirëmbajtjen e rrjetit primar dhe sekondar të ujit të pijes;
- Mirëmbajtjen e rrjetit primar dhe sekondar ujërave të përdorura;
- Mirëmbajtjen energjetike dhe makinerike;
- Mirëmbajtjen e pajisjeve të punës dhe aparaturave;
- Kujdesi i shtuar dhe kontrolli, për ruajtjen e burimeve të ujit në liqenet akumuluese dhe puseve nëntokësore;
- Kontrollimi dhe deklarimi i cilësisë së ujit të pijes dhe ujërave të ndotura – të trajtuara;
- Zhvillimin dhe avancimin tekniko teknologjik të sistemit në tërësi.

Viti 2021, përkatësisht koha deri në të cilën po përgatitet ky Plan i biznesit është karakterizuar me një situatë relativisht të favorshme sa i përket rezervave të ujit nëpër Liqenet akumuluese dhe në burimet nëntokësore në të gjithë zonën e shërbimit, pavarësisht që kishte një verë të gjatë, me temperatura tropikale.

Është bërë mirëmbajtja e rregullt e tërë sistemit të ujit të pijes dhe ujërave të ndotura.

Kualiteti i ujit të distribuuar në tërë zonën e shërbimit i është përgjigjur normave të Udhëzimit administrativ numër 16/2012 dhe është arritur të monitorohet dhe kontrollohet rregullisht kualiteti i ujit nga laboratorit qendror dhe laboratorët lokale të KRU "Prishtina" Sh.A. Ankesat në kualitet të ujit kanë qenë minimale, ndërsa bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik ka qenë i nivelit të lartë.

Përveç veprimeve ditore në operimet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe stabilimenteve të tjera të përpunimit dhe shpërndarjes së ujit, në këtë rast është shumë e rëndësishme të theksojmë se për herë të parë kanë nisur përgatitjet substanciale për studimin dhe përpilimin e "Master Plani" për 8 komunat në zonën e shërbimit dhe Fizibiliteti për rrjetin e ujërave të ndotura në Prishtinë dhe rrethinë (Obiliq, Fushë Kosovë dhe Graçanicë)". Për këtë projekt janë siguruar fondet nga KFW dhe Unionin Evropian në vlerë prej 1,950,000 €.

Përmes këtij studimi do të përcaktohen të gjitha modalitetet, mundësitë dhe ofrohen zgjidhjet më të mira për zgjidhjen përfundimtare të mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit nga kontaminimi i lumenjëve me ujërat e ndotura të Prishtinës dhe rrethinës, duke përmirësuar në përgjithësi mjedisin dhe lokalitetet ku banohet.

## 7.3 Pasqyra krahasuese e treguesve operativë dhe financiarë 2020 & 2021

Në tabelën vijuese janë paraqitur përmes shifrave disa nga treguesit e performacës. Këta tregues janë vënë në raport me vitin paraprak (2020) si dhe me Planin e biznesit për vitin 2021. Treguesit janë pasqyruar në vlerë absolute (sasi - m<sup>3</sup>, vlerë - € dhe numër - #) si dhe në vlerë relative (përqindje - %) duke vënë në raport vitin aktual me vitin paraprak dhe vitin aktual me Planin e biznesit.

**Tabela nr. 17 Pasqyra krahasuese e treguesve operativë dhe financiarë 2021 & 2022**

| Treguesit e performancës |                | Faktike    | Plani      | Plan/Faktike | Ndryshimi | Ndryshimi |
|--------------------------|----------------|------------|------------|--------------|-----------|-----------|
|                          |                | 2020       | 2021       | 2021         | 2021/2020 | 2021/2021 |
| Uji i përpunuar          | m <sup>3</sup> | 52,961,479 | 49,594,950 | 53,338,188   | 376,709   | 3,743,238 |

|                                    |                |            |            |            |           |            |
|------------------------------------|----------------|------------|------------|------------|-----------|------------|
| Uji i faturuar                     | m <sup>3</sup> | 22,298,999 | 25,594,922 | 24,096,577 | 1,797,578 | -1,498,345 |
| Konsumatorë të regjistruar         | nr             | 162,693    | 166,954    | 169,543    | 6,850     | 2,589      |
| Numri i faturave                   | nr             | 148,510    | 151,889    | 153,980    | 5,470     | 2,091      |
| Numri i konsumatorëve me matje     | nr             | 145,328    | 148,850    | 153,980    | 8,652     | 5,130      |
| Uji i faturuar i matur             | m <sup>3</sup> | 22,270,897 | 24,571,125 | 24,096,577 | 1,825,680 | -474,547   |
| Vlera e faturimit                  | €              | 13,814,269 | 15,741,048 | 15,033,628 | 1,219,359 | -707,420   |
| Vlera e arkëtimit                  | €              | 11,490,653 | 14,829,435 | 13,732,721 | 2,242,068 | -1,096,714 |
| Të hyra tjera operative            | €              | 77,103     | 211,883    | 209,333    | 132,230   | -2,550     |
| Shpenzimet operative               | €              | 10,505,479 | 10,624,400 | 10,624,400 | 118,921   | 0          |
| Investimet vetanake                | €              | 645,298    | 1,465,000  | 1,735,000  | 1,089,702 | 270,000    |
| Të hyrat jo operative              | €              | 2,210,361  | 2,261,096  | 2,210,361  | 0         | -50,735    |
| Borxhet e akumuluar të papaguara   | €              | 67,211,772 | 68,335,268 | 68,722,011 | 1,510,239 | 386,743    |
| Numri i punëtorëve                 | nr             | 557        | 559        | 615        | 58        | 56         |
| Uji i faturuar                     | %              | 42.10%     | 51.61%     | 45.18%     |           |            |
| Uji i pa faturuar                  | %              | 57.90%     | 48.39%     | 54.82%     |           |            |
| Përqindja e faturimit              | %              | 99.87%     | 96.00%     | 100.00%    |           |            |
| Shkalla e përgjithshme e arkëtimit | %              | 83.18%     | 94.21%     | 91.35%     |           |            |
| Norma e punës                      | #              | 1.10       | 1.42       | 1.31       |           |            |
| Konsumatorë/punëtorë               | #              | 292        | 299        | 276        |           |            |
| Shpenzimet e operimit për konsum.  | €              | 5.04       | 4.67       | 5.02       |           |            |

#### 7.4 Rekrutimi i personelit të ri gjatë vitit 2022

Gjatë vitit 2021 nuk është përmbushur planifikimi i punësimit me personel të ri të domosdoshëm për kryerjen e të gjitha punëve. Kjo gjë ka ndodhur si rezultat i gjendjes së përgjithshme shëndetësore që ka mbretëruar në Kosovë për shkak të karantinimit të me qëllim të mospërhapjes së virusit "Covid -19", ngase nuk janë zëvendësuar as personeli që është pensionuar apo do të pensionohen deri në fund të vitit 2021. Pavarësisht se kishte kërkesa nga menaxhmenti për të lejuar hapjen e konkurseve, diçka e tillë nuk u rekomandua/lejuar nga Bordi i Drejtorëve, pasi që kishim vit me dy palëve zgjedhje (Nacionale dhe Lokale).

Deri në përfundim të vitit fiskal ka mbetur një kohë relativisht e shkurtër deri në përmbushje të synimeve, andaj planifikohen të rekrutohen për punësim 56 punëtorë të rinj sipas kësaj strukture të paraqitur në vijim:

**Tabela nr. 18 Planifikimet për punësimet e reja në Ndërmarrje**

| Nr. | Emërtim i vendit të punës         | Numri i punëtorëve |
|-----|-----------------------------------|--------------------|
| 1   | Arkëtarë                          | /                  |
| 2   | Lexues                            | 11                 |
| 3   | Inxhinier i gjeodezisë            | 1                  |
| 4   | Inxhinier i Hidro-së              | 2                  |
| 5   | Inxhinier automatik - mekatronike | 1                  |

|              |                                                   |           |
|--------------|---------------------------------------------------|-----------|
| 6            | Elektricitist teknik                              | 3         |
| 7            | Operator të pompave (SP Vrellë)                   | 1         |
| 8            | Operator në ITUN (Vrellë)                         | 4         |
| 9            | Operator në pompa                                 | 4         |
| 10           | Kimist laborant                                   | 0         |
| 11           | Ujë instalues                                     | 7         |
| 12           | Punëtor fizik– kanalizator                        | 5         |
| 13           | Punëtor fizik në mirëmbajtje                      | 5         |
| 14           | Pastrues punëtorë fizik                           | 4         |
| 16           | Inxhinier i rrjetit (Senior)                      | 1         |
| 17           | Manipulues - drejtues në makina të punues - bager | 2         |
| 18           | Teknik i makinerisë për Laboratorin e bazhdarimit | 1         |
| 19           | Automekanikë                                      | 2         |
| 20           | Dispeçer                                          | 1         |
| 21           | Kontabilist                                       | 1         |
| <b>Total</b> |                                                   | <b>56</b> |

*Vërejtje:* Numri i punëtorëve të planifikuar përfshin diferencën nga viti 2021 në vitin 2022 e cila është (559 - 615) 56 punëtorë të rinj dhe punëtorë të cilët janë pensionuar ose do të pensionohen përgjatë periudhës së këtij Plani të biznesit

## 8. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PLANIFIKIMI I PERSONELIT

### 8.1 Struktura organizative

KRU "Prishtina" Sh.A. është kompani publike rajonale, përkatësisht ndërmarrje e korporatizuar. Kompania më 01.07.2007 është organizuar në cilësinë e shoqërisë aksionare. Kapitali aksionar vlerësuar në 25,000 aksione, të gjitha në vlerë nominale prej 1 € për çdo aksion.

Në pajtim me Ligjin mbi kompanitë publike dhe Ligjin mbi shoqëritë tregtare (cituar më lartë), Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e vetme e të gjitha aksioneve të Kompanisë. Ministria e Ekonomisë në emër të pronarit (aksioneve) e ushtron kompetencën dhe përgjegjësinë në bazë të Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore.

### 8.2 Struktura menaxhuese

Kompania menaxhohet drejtpërdrejtë nga zyrtarët e lartë të kompanisë:

- Kryeshefi ekzekutiv
- Zëvendës kryeshef ekzekutiv
- Zyrtari i Lartë Financiar dhe Thesarit
- Sekretari dhe
- Auditori i brendshëm

Në vartësi të drejtpërdrejtë të Kryeshefit ekzekutiv gjithashtu janë:

- Drejtori Teknik,
- Drejtori Komercial si dhe

- Zyrtarët e tjerë nënrenditës të zgjedhur (në pajtim me Ligjin në fuqi).


Menaxhimi kryhet edhe përmes bartësve të niveleve më të ulët: menaxherët ekzekutiv të departamenteve, shefat e shërbimeve teknike dhe administrative, menaxherët e Njësive Operative të Ujësjetësve, Udhëheqësit e Impianteve për Trajtimin e Ujit, koordinatorët, zyrtarët etj.

### 8.3 Skema organizative - Organogrami

Skema organizative e KRU "Prishtina" Sh.A. është e modelit të piramidës në delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nga "lartë-poshtë", kryerjen dhe raportimin e përmbushjes së të njëjtave nga "poshtë-lartë". Skema organizative aktuale është miratuar nga Bordit të Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2020, vendimi nr. 2020/ 1640.

Skema mund të ndryshojë vetëm në rast të ndryshimeve të domosdoshme që mund të bëjë në emër të aksionarit e bën Bordi i Drejtorëve (Qeveria e Republikës së Kosovës). Bordi do të rishikojë sipas nevojës strukturën organizative.

Grafikoni nr. 7 Skema Organizative



## 8.4 Numri total i personelit operativ - teknik dhe financiar - administrativ

KRU "Prishtina" Sh.A., në Prishtinë në periudhën ndërmjet viteve 2022 - 2024 (duke përfshirë edhe njësitë operative të konsoliduara) tërë procesin e përpunimit, shpërndarjes - distribuimit, shërbimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura do ta përmbyllë me mesatarisht 615 deri 650 punëtorë (në vitin e fundit të këtij Planit të biznesit - 2024).

Raportet, përgjegjësitë, detyrimet dhe kompetencat ndërmjet stafit janë të përcaktuara mbi bazë të Skemës organizative dhe Rregullores mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm duke përfshirë edhe përshkrimin e detajuar të vendeve të punës.

Personeli që kryen punët dhe detyrat në KRU "Prishtina" Sh.A. është heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i përfaqësimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqësimit gjinor;
- Nga aspekti i përfaqësimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

## 8.5 Ristrukturimi i personelit

Me qëllim të kufizimit të shpenzimeve të panevojshme përkatësisht rritjes së efikasitetit në punë, menaxhmenti i përkrahur nga palët e interesit do të jetë i kujdesshëm që të vlerësojë mundësinë e ristrukturimit të personelit ndërmjet shërbimeve të caktuara brenda ndërmarrjes.

Rishikimi i mundësisë do të orientohet duke analizuar në mënyrë të detajuar funksionimin e organogramit dhe transferit nga pjesa e shërbimeve administrative drejtë shërbimeve teknike dhe komerciale nën kujdesin e shtuar për rritjen e nivelit të shërbimit.

## 8.6 Struktura kualifikuese dhe gjinore

Personeli i KRU "Prishtina" Sh.A., në aspektin e përgatitjeve shkollore, kompetencave dhe përgjegjësi është shumë heterogjene. Prandaj kjo diferencë e bën të vështirë rritjen e shkallës së produktivitetit dhe menaxhimit më të mirë të personelit.

Në vazhdim është paraqitur tabela e kualifikimeve dhe certifikatave shkollore për të gjithë të punësuarit si dhe struktura gjinore e personelit.

**Tabela nr. 19** Tabela e kualifikimeve dhe certifikatave shkollore për të gjithë të punësuarit si dhe struktura gjinore e personelit

| Emërtimi | Struktura kualifikuese |            |     |            |     |     |       |          |             |             | Totali |
|----------|------------------------|------------|-----|------------|-----|-----|-------|----------|-------------|-------------|--------|
|          | PhD                    | PSP-master | PSP | PLP-master | PLP | PMP | Sh.F. | K. Lartë | Diplomë,    | Shofer kat. |        |
|          |                        |            |     |            |     |     |       |          | çertifikatë | të ndryshme |        |

|                        |          |           |           |           |           |            |           |          |           |          |            |
|------------------------|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|-----------|----------|-----------|----------|------------|
| Meshkuj                | 2        | 6         | 24        | 25        | 53        | 321        | 16        | 0        | 21        | 9        | 477        |
| Femra                  | 0        | 3         | 13        | 9         | 27        | 27         | 1         | 0        | 2         | 0        | 82         |
| <b>Totali</b>          | <b>2</b> | <b>11</b> | <b>37</b> | <b>34</b> | <b>80</b> | <b>348</b> | <b>17</b> | <b>0</b> | <b>23</b> | <b>9</b> | <b>559</b> |
| Struktura-meshkuj në % | 100%     | 55%       | 65%       | 74%       | 66%       | 92%        | 94%       | 0        | 91%       | 100%     | 85%        |
| Struktura-femra në %   | 0%       | 27%       | 35%       | 26%       | 34%       | 8%         | 6%        | 0        | 9%        | 0%       | 15%        |

## 8.7 Struktura nacionale

Zona e shërbimit të KRU "Prishtina" Sh.a., edhe nga aspekti i përbërjes nacionale është mjaft heterogjen. Në vazhdimësi i është kushtuar kujdes edhe përfaqësimit nacional.

Struktura nacionale është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr. 20 Struktura nacionale


| Emërtimi       | Struktura nacionale |      |          |      |      |        |
|----------------|---------------------|------|----------|------|------|--------|
|                | Shqiptar            | Serb | Boshnjak | Turq | Roma | Totali |
| Punëtorë       | 543                 | 15   | 1        | /    | /    | 559    |
| Struktura në % | 97%                 | 3%   | 0%       | 0%   | 0%   | 0%     |

## 8.8 Struktura moshës së personelit

Fatkeqësisht moshë mesatare e personelit të punësuar në KRU "Prishtina" Sh.A., në përfundim të muajit gusht 2021 është rreth 48,16 vjeç. Kjo konsiderohet si një moshë kritike dhe alarm për ripërtëritjen e personelit.

Në grafikonin e mëposhtëm është pasqyruar moshë e personelit sipas grup moshave. Kompensimi i pagës për punën, për të gjithë personelin, konsiderojmë se iu është qasur në mënyrë komplekse.

Grafikoni nr. 8 Struktura e të punësuarave në KRU Prishtina Sh.a për vitin 2021



Të gjithë të punësuarit përveç pagës bazë iu kompensohet edhe shtesa për ushqimin ditor dhe shtesat tjera që derivojnë nga Ligji i punës dhe Kontrata kolektive.


## 8.9 Numri i personelit në raport me numrin e konsumatorëve

Një kujdes i veçantë do të i kushtohet çështjes së raportit midis numrit të personeli të nevojshëm për kryerjen e detyrave të punës dhe numrit total të konsumatorëve. Tendenca e menaxhmentit përmes implementimit të këtij Planit të biznesit është rritja e produktivitetit në punë përkatësisht zvogëlimi i numrit të personelit në raport me numrin e konsumatorëve (e llogaritur për punëtor).

**Tabela nr. 21 Krahimi mes nr. të personelit ne raport me konsumatorë**

| Treguesit e performancës                  | 2019    | 2020    | 2021    | 2022    | 2023    | 2024    |
|-------------------------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|
| Numri i konsumatorëve aktiv               | 141,224 | 148,510 | 151,889 | 157,964 | 164,282 | 172,743 |
| Numri i punëtorëve                        | 584     | 557     | 559     | 615     | 630     | 650     |
| Numri i konsumatorëve për një të punësuar | 242     | 267     | 272     | 257     | 261     | 266     |

**Grafikoni nr. 9, Numri i konsumatorëve për një të punësuar**



Grafikoni paraparak na tregon se numri i konsumatorëve është rritur në trend më të madh në krahasim me rritjen e numrit të punëtorëve. Në vitin 2017 shohim se ka qenë i punësuar mesatarisht një punëtor për 236 konsumatorë. Tendenca e rritjes së konsumatorëve prej vitit në vit është treguesi më i mirë i rritjes së vëllimit të punës për një pjesë të personalit përkatësisht rritja e produktivitetit në punë. Në përfundim të periudhës së këtij Planit të biznesit pritet të jetë rreth 275 konsumatorë për një punëtor.

## 9. BUXHETI I KRU "PRISHTINA" Sh.A.

Të hyrat dhe shpenzimet si kategori eksplicite të Buxhetit të KRU "Prishtina" Sh.A. reflekton në mënyrën të plotë dhe domethënëse në politikën financiare edhe operative të menaxhimit financiar të të gjitha proceseve të punës. Buxheti, pjesë përbërëse e Planit të biznesit përmban instrumentin kryesor të aktivitetit ekonomik të kompanisë dhe zë një vend dominues në strukturën e gjithmbarshme të këtij dokumenti përgjatë periudhës së vlefshmërisë 2022-2024.

Buxheti si një akt, përcakton të gjitha linjat e të ardhurave, shpenzimeve të operimit dhe të mirëmbajtjes nga njëra dhe investimeve të kompanisë nga fondet e kompanisë dhe pagesën e kryeqjësë dhe kamatave për kreditë e Prishtina II dhe Prishtina III nga ana tjetër brenda një viti fiskal (2022).

### 9.1 Buxheti vjetor për vitin 2022 dhe parashikimet për periudhën 2023- 2024

Buxheti është i balancuar në termat e arkëtimit (të hyrave nga shërbimet e ofruara ndaj klientëve) dhe të pagesave (shërbimet e pranuar nga palët e treta). Të gjitha arkëtimet dhe pagesat e kompanisë kryhen nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit, e mbajtur në euro. Llogaritë e unifikuar të thesarit mbahet në Bankat komerciale të certifikuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Në tabelën në vijim mbi baza vjetore janë paraqitur kategoritë të cilat përbëjnë në esencë veprimtarinë themelore të kompanisë.

**Tabela nr. 22 Buxheti vjetor për vitin 2022 dhe parashikimet për periudhën 2023 – 2024**

| Elementet                             | Vitet             |                   |                   |                   |
|---------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
|                                       | Buxhetuar         | Buxhetuar         | Projektuar        | Projektuar        |
|                                       | 2021              | 2022              | 2023              | 2024              |
| Të hyrat e arkëtuara                  | 14,829,435        | 15,432,331        | 15,732,548        | 16,204,524        |
| Te hyrat e ark. nga subvencioni       | 0                 | 0                 | 0                 | 0                 |
| Të hyrat tjera                        | 211,883           | 222,477           | 244,725           | 235,937           |
| <b>Total të ardhurat</b>              | <b>15,041,318</b> | <b>15,654,808</b> | <b>15,977,272</b> | <b>16,440,461</b> |
| Kategorizimi i shpenzimeve            |                   |                   |                   |                   |
| Vlera ujit të papërpunuar             | 792,276           | 848,912           | 832,867           | 857,853           |
| Shpenzimet e energjisë                | 2,506,793         | 2,616,012         | 3,079,902         | 3,172,299         |
| Shpenzimet e karburanteve             | 139,021           | 123,202           | 146,144           | 150,528           |
| Shpenzimet e personelit               | 5,613,917         | 5,733,305         | 5,901,537         | 6,078,583         |
| Shpenzimet materiale                  | 700,464           | 691,474           | 736,351           | 758,442           |
| Shërbimet e jashtme kontraktuese      | 707,530           | 698,449           | 643,779           | 616,093           |
| Shpenzimet e ndihmave solidare        | 8,518             | 9,144             | 8,954             | 9,223             |
| Shpenz. mirëmb. & ripar.              | 129,234           | 110,530           | 135,855           | 139,931           |
| Të dalurat financiare                 | 26,647            | 74,591            | 28,012            | 28,853            |
| <b>Total shpenzimet</b>               | <b>10,624,400</b> | <b>10,905,620</b> | <b>11,513,401</b> | <b>11,811,803</b> |
|                                       |                   |                   |                   |                   |
| Rezerva financiare                    | 212,488           | 334,669           | 125,392           | 305,000           |
| <b>Diferenca-arkëtimi- shpenzimet</b> | <b>4,204,430</b>  | <b>4,414,519</b>  | <b>4,338,479</b>  | <b>4,323,658</b>  |
|                                       |                   |                   |                   |                   |
| Investimet kapitale                   | 1,465,000         | 1,735,000         | 1,775,000         | 1,765,000         |
|                                       |                   |                   |                   |                   |

|                    |               |               |               |                  |
|--------------------|---------------|---------------|---------------|------------------|
| Pagesat e kredive  | 2,697,000     | 2,624,000     | 2,552,000     | 1,369,000        |
| <b>Mbetja neto</b> | <b>42,430</b> | <b>55,519</b> | <b>11,479</b> | <b>1,189,658</b> |

Në vazhdim kemi dy tabela të cilat përmbajnë analitiken e shpenzimeve për këto dy kategori në analitikë ku si rrjedhojë e vlerave financiare grumbullohen dhe prezantohen ne Pasqyrat financiare me totale.

**Tabela nr. 23 Buxheti vjetor për vitin 2022 dhe parashikimet për periudhën 2023- 2024 sa i përket shpenzimeve materiale**

| Kodi          | Përshkrimi                                          | Vitet          |                |                |                |
|---------------|-----------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
|               |                                                     | 2021           | 2022           | 2023           | 2024           |
| K5300         | Shpenzimet e materialit harxhues                    | 429,709        | 441,083        | 469,710        | 483,801        |
| K5302         | Shpenzimet e mjeteve te mbrojtjes ne pune-depo      | 28,787         | 29,549         | 31,467         | 32,411         |
| K5303         | Shpenzimet e inventarit te imtëe-depo               | 29,381         | 30,158         | 32,116         | 33,079         |
| K5304         | Shpenzimet e autogomave-depo                        | 12,013         | 12,331         | 13,131         | 13,525         |
| K5305         | Shpenzimet e materialit administrativ-depo          | 15,934         | 16,355         | 17,417         | 17,939         |
| K5307         | Shpenzimet e materialit-kemikalje dhe reagencia     | 150,693        | 154,682        | 164,721        | 169,663        |
| K5310         | Shp.material.harxh.-Mirëmbajtja rrjetit ujit, kanal | 1,686          | 1,731          | 1,843          | 1,898          |
| K5312         | Shpenzimet e mjeteve te mbrojtjes ne pune           | 5,440          | 5,584          | 5,946          | 6,125          |
| <b>Totali</b> |                                                     | <b>673,643</b> | <b>691,474</b> | <b>736,351</b> | <b>758,442</b> |

**Tabela nr. 24 Buxheti vjetor për vitin 2022 dhe parashikimet për periudhën 2023- 2024 sa i përket shpenzimeve të jashtme kontraktuese**

| Kodi  | Përshkrimi                                           | Vitet   |         |         |         |
|-------|------------------------------------------------------|---------|---------|---------|---------|
|       |                                                      | 2021    | 2022    | 2023    | 2024    |
| K5340 | Shpenzimet e akomodimit gjate udhëtimit zyrtar       | 1,621   | 1,985   | 2,055   | 2,236   |
| K5341 | Shpenzimet tjera gjate udhëtimit zyrtar dhe akomodim | 1,726   | 2,114   | 2,188   | 2,381   |
| K5401 | Shpenzimet e telefonisë mobile dhe internet          | 10,485  | 12,839  | 13,287  | 14,459  |
| K5410 | Shpenzimet e licencës për ARRU                       | 111,705 | 136,779 | 141,554 | 154,039 |
| K5411 | Shpenzimet për lejen ujore                           | 39,384  | 48,224  | 49,908  | 54,309  |
| K5412 | Shpenzimet e licencës për programe                   | 10,202  | 12,492  | 12,928  | 14,068  |
| K5421 | Shpenzimet e interesit                               | 275,000 | 202,000 | 130,000 | 57,000  |
| K5422 | Tatimi ne pronësore                                  | 2,022   | 2,476   | 2,562   | 2,788   |
| K5423 | Tatimi ne fitim                                      | 2,979   | 3,648   | 3,775   | 4,108   |
| K5424 | Tatimi ne burim për qira, lojëra fati etj.           | 3,741   | 4,580   | 4,740   | 5,158   |
| K5425 | Taksa komunale e firmës                              | 3,484   | 4,266   | 4,415   | 4,805   |
| K5431 | Anëtarësia ne SHUKOS                                 | 12,242  | 14,990  | 15,514  | 16,882  |
| K5432 | Anëtarësia ne organizata regjionale-ndërkombëtare    | 2,857   | 3,498   | 3,620   | 3,939   |
| K5441 | Shpenzimet e bartjes se mbeturinave                  | 8,739   | 10,701  | 11,075  | 12,051  |
| K5443 | Shpenzimet e Ujit për pije                           | 30,459  | 37,297  | 38,599  | 42,003  |
| K5451 | Shpenzimet e reprezentacionit                        | 2,652   | 3,247   | 3,360   | 3,657   |
| K5454 | Shpenzimet e bufesë (Menaxhmenti drejtoria)          | 6,322   | 7,741   | 8,012   | 8,718   |
| K5461 | Shërbimet e ndryshme kontraktuese (Sig.për qkyqe)    | 2,169   | 2,655   | 2,748   | 2,990   |

|               |                                                     |                |                |                |                |
|---------------|-----------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| K5470         | Shpenzimet për marrjen me qira te objekt. Ndërtimor | 32,041         | 39,233         | 40,603         | 44,184         |
| K5472         | Shpenzimet për marrje me qira te TI (fotokopje,)    | 4,674          | 5,723          | 5,923          | 6,445          |
| K5480         | Shpenzimet për sigurimin e automjeteve              | 14,772         | 18,088         | 18,719         | 20,370         |
| K5481         | Shpenzimet për rexhistrimin e automjeteve           | 5,548          | 6,794          | 7,031          | 7,651          |
| K5485         | Taksa rrugore e Republikës se Kosovës               | 5,182          | 6,346          | 6,567          | 7,146          |
| K5490         | Shpenzimet për transfere te transaksioneve bankare  | 71,768         | 87,878         | 90,946         | 98,967         |
| K5491         | Shpenzimet e shzillimit të vazhdueshëm profesional  | 4,204          | 5,147          | 5,327          | 5,797          |
| K5492         | Shpenzimet e trajnimit, seminare, anëtarësimit etj. | 3,164          | 3,874          | 4,010          | 4,363          |
| K5495         | Shpenzimet e marketingut                            | 8,406          | 10,293         | 10,652         | 11,592         |
| K5498         | Shpenzimet e mirëmbajtjes se softuerit              | 1,927          | 2,359          | 2,442          | 2,657          |
| K54991        | Shpenzimet për taksa gjyqësore dhe administrative   | 964            | 1,181          | 1,222          | 1,330          |
| <b>Totali</b> |                                                     | <b>680,439</b> | <b>698,449</b> | <b>643,779</b> | <b>616,093</b> |

## 9.2 Buxheti mujor për vitin 2022

Gjatë planifikimit të të hyrave mujore, është përdorë metoda progresive e rritjes së sasisë së ujit të faturuar dhe rrjedhimisht edhe vlerës financiare. Fillimisht në janar është nisur kryesisht nga gjendja që ka dominuar në fund të periudhës janar - gusht dhe pjesa e modifikuar e periudhës shtator - dhjetor 2021. Prandaj në bazë të këtij parimi muajt e parë të vitit objektivat janë më lehtë të zbatueshme dhe rritja në kalimin e muajve është e dukshme.

Menaxhmenti gjatë planifikimit të biznesit, ka qenë në kujdes të vazhdueshëm rreth trajtimit të kategorisë së të hyrave dhe kategorisë së shpenzimeve duke pasur në konsideratë edhe që kategoria e shpenzimeve në çdo muaj të jetë më e vogël se kategoria e të hyrave, duke realizuar një diferencë pozitive dhe tepriçë e të ardhurave të mbetura.

## 9.3 Faturimet dhe arkëtimet e shërbimeve bazë

Të gjitha të ardhurat e krijuara nga shitja e shërbimeve ujit, ujërave të ndotura dhe tarifës fikse nga njëra anë si dhe shërbimeve tjera sekondare në bazë të Urdhëresës së tarifës, të ardhurat nga taksat dhe tarifat, të hyrat e shtyra nga grantet dhe donacionet nga palët e treta, të hyrat nga interesat, të hyrat nga transaksionet financiare të gjitha këto të agreguara përfaqësojnë në total vlerën vjetore të të hyrave të kompanisë.

Gjatë vitit 2021, vlera totale e faturimeve të shërbimeve bazë do të sillet rreth 15,033,628 € nga të dhënat faktike janar-shtator 2021 dhe tetor-dhjetor 2021 të planifikuara duke mos përfshirë njëkohësisht edhe të hyrat nga veprimtaria dytësore në vlerë prej 222,477 € si dhe të hyrat e shtyra (grantet) në vlerë 2,210,361 €. Të gjitha këto të hyra nga shërbimet e KRU "Prishtina" Sh.A. në total kapin vlerën prej 17,506,606 €.

Fatkeqësisht, ndërmarrjet publike përkatësisht të hyrat publike në Republikën e Kosovës njëjtë sikurse edhe në KRU "Prishtina" Sh.A., nuk po arkëtohen në shkallën optimale. Ndikim themelor në mos arkëtimin e tërësishëm të faturave të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit kanë konsumatorët e klasifikuar si përfitues të skemave sociale rreth 6% sipas një vlerësimi të bërë nga kompania në vitin 2012 përmes krahasimit të dhënave me departamente çështjeve sociale të Ministrisë së punës, rregullativa ligjore që pamundëson çkyqjen nga rrjeti i furnizimit objektet e banimit kolektiv dhe fshatrat në zonën e shërbimit. Përveç këtyre faktorëve, duke marrë në konsideratë kohën kur po përgatitet ky dokument, i shoqëruar edhe më një infeksion tepër të madh me virusin "Covid-19", i cili gjatë vitit 2020 ka pasur ndikim të konsiderueshëm në veprimtarinë e kompanisë. Rritja e infeksioneve dhe eventualisht mbyllja e ekonomisë përkatësisht falimentimi i një pjese të bizneseve private përkatësisht zvogëlimi i të hyrave buxhetore të shtetit do të ketë ndikim substancial edhe në arkëtimet e shërbimeve të kompanisë.

Këto të hyra të faturuara vështirë arkëtohen, prandaj norma e arkëtimin pritet të jetë rreth 95,32 % përkatësisht 15,432,331 € vlerë e arkëtuar. Përmes plotësimit të këtij kriteri mundësohet financimi i shpenzimeve të operimit, kthimi i kryegjësë dhe kamatave për fazat investive "Prishtina III" dhe "Prishtina II" duke mundësuar edhe një listë të investime kapitale dhe të mirëmbajtjes që do të jetë pjesë përbërëse e Planit të biznesit 2022 - 2024.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të hyrat e faturuara në baza mujore sipas kategorive të konsumatorëve nga njëra anë, si dhe arkëtimeve mujore gjithashtu sipas kategorive të konsumatorëve.

Norma - përqindja e arkëtimin është nxjerrë si raport i vlerës së të ardhurave të arkëtuara dhe vlerës së faturimit për çdo kategori ndaras por edhe në total të kompanisë.

Në tabelën në vazhdim, në baza mujore është paraqitur në mënyrë analitike të hyrat e faturuara, arkëtuara sipas katër kategorive të konsumatorëve duke përfshirë edhe të hyrat nga shërbimet dytësore që bënë kompania ndaj palëve të treta.


Përkushtimi për përmbushjen e objektivave të parashikuara në Buxhetin e kompanisë garantojnë një likuiditet të kompanisë dhe siguri të vazhdimësisë së veprimtarisë.

Tabela nr. 25 Tabela mujore e faturimit, arkëtimit dhe norma e arkëtimit për vitin 2022

| Elementet                  | Janar            | Shkurt           | Mars             | Prill            | Maj              | Qershor          | Korrik           | Gusht            | Shtator          | Tetor            | Nëntor           | Dhjetor          | Total             |
|----------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|
| Faturimi-amvisëri          | 944,426          | 840,433          | 933,000          | 912,531          | 949,562          | 958,072          | 1,055,562        | 1,094,801        | 1,013,385        | 991,116          | 968,793          | 1,039,323        | <b>11,701,005</b> |
| Faturimi-BV                | 121,478          | 109,174          | 120,046          | 117,729          | 122,045          | 123,155          | 134,615          | 139,259          | 129,658          | 126,868          | 124,337          | 132,599          | <b>1,500,963</b>  |
| Faturimi-BM                | 74,617           | 65,316           | 73,840           | 71,971           | 75,238           | 75,607           | 83,566           | 86,664           | 80,044           | 78,723           | 76,674           | 82,556           | <b>924,815</b>    |
| Faturimi-Institucione      | 166,917          | 142,949          | 163,349          | 158,654          | 166,350          | 168,437          | 190,270          | 199,002          | 180,048          | 173,824          | 168,688          | 184,151          | <b>2,062,640</b>  |
| <b>Faturimi-Total</b>      | <b>1,307,439</b> | <b>1,157,872</b> | <b>1,290,235</b> | <b>1,260,885</b> | <b>1,313,195</b> | <b>1,325,272</b> | <b>1,464,013</b> | <b>1,519,726</b> | <b>1,403,135</b> | <b>1,370,530</b> | <b>1,338,491</b> | <b>1,438,630</b> | <b>16,189,423</b> |
|                            |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                   |
| Norma arkëtimit-amvis.     | 90.16%           | 90.65%           | 91.45%           | 92.11%           | 92.80%           | 93.50%           | 94.24%           | 94.90%           | 95.48%           | 95.90%           | 96.19%           | 96.65%           | 93.77%            |
| Norma arkëtimit-BV         | 97.22%           | 97.76%           | 98.27%           | 98.79%           | 99.31%           | 99.44%           | 99.56%           | 99.65%           | 99.77%           | 99.88%           | 99.98%           | 100.07%          | 99.18%            |
| Norma arkëtimit-BM         | 97.20%           | 97.75%           | 98.28%           | 98.83%           | 99.37%           | 99.52%           | 99.67%           | 99.76%           | 99.88%           | 99.99%           | 100.10%          | 100.19%          | 99.26%            |
| Norma arkëtimit-Instit.    | 99.00%           | 99.10%           | 99.20%           | 99.30%           | 99.40%           | 99.50%           | 99.60%           | 99.70%           | 99.80%           | 99.90%           | 99.95%           | 100.00%          | 99.55%            |
|                            |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                   |
| <b>Norma mesat. arkët.</b> | <b>92.35%</b>    | <b>92.77%</b>    | <b>93.46%</b>    | <b>94.02%</b>    | <b>94.62%</b>    | <b>95.16%</b>    | <b>95.73%</b>    | <b>96.24%</b>    | <b>96.68%</b>    | <b>97.01%</b>    | <b>97.24%</b>    | <b>97.60%</b>    | <b>95.32%</b>     |
|                            |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                   |
| Arkëtimi-amvisëri          | 851,475          | 761,887          | 853,252          | 840,564          | 881,169          | 895,777          | 994,735          | 1,038,957        | 967,539          | 950,448          | 931,927          | 1,004,556        | <b>10,972,284</b> |
| Arkëtimi-BV                | 118,106          | 106,725          | 117,967          | 116,308          | 121,207          | 122,465          | 134,018          | 138,778          | 129,355          | 126,709          | 124,311          | 132,698          | <b>1,488,649</b>  |
| Arkëtimi-BM                | 72,530           | 63,844           | 72,572           | 71,126           | 74,760           | 75,245           | 83,287           | 86,458           | 79,946           | 78,718           | 76,748           | 82,713           | <b>917,947</b>    |
| Arkëtimi-institucione      | 165,248          | 141,663          | 162,042          | 157,543          | 165,352          | 167,595          | 189,509          | 198,405          | 179,687          | 173,650          | 168,604          | 184,151          | <b>2,053,451</b>  |
| <b>Arkëtimi total</b>      | <b>1,207,358</b> | <b>1,074,118</b> | <b>1,205,835</b> | <b>1,185,542</b> | <b>1,242,488</b> | <b>1,261,082</b> | <b>1,401,549</b> | <b>1,462,598</b> | <b>1,356,527</b> | <b>1,329,525</b> | <b>1,301,591</b> | <b>1,404,118</b> | <b>15,432,331</b> |

Në vazhdim, në grafikon është paraqitur trendi mujor i faturimit dhe arkëtimit të faturave nga shërbimet bazë duke paraqitur njëkohësisht edhe normën e arkëtimit.

**Grafikoni nr. 10 Trendi mujor i faturimit dhe arkëtimit të faturave nga shërbimet bazë duke paraqitur njëkohësisht edhe normën e arkëtimit**





Të hyrat e arkëtuara sipas katër kategorive të konsumatorëve duke përfshirë edhe të hyrat nga shërbimet dytësore që bënë kompania ndaj palëve të treta.

**Tabela nr. 26 Të hyrat e arkëtuara sipas katër kategorive të konsumatorëve duke përfshirë edhe të hyrat nga shërbimet dytësore për vitin 2022 që bënë kompania ndaj palëve të treta**


| Elementet                               | Janar            | Shkurt           | Mars             | Prill            | Maj              | Qershor          | Korrik           | Gusht            | Shtator          | Tetor            | Nëntor           | Dhjetor          | Total             |
|-----------------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|
| Arkëtimi-amvisëritë                     | 851,475          | 761,887          | 853,252          | 840,564          | 881,169          | 895,777          | 994,735          | 1,038,957        | 967,539          | 950,448          | 931,927          | 1,004,556        | 10,972,284        |
| Arkëtimi-BV                             | 118,106          | 106,725          | 117,967          | 116,308          | 121,207          | 122,465          | 134,018          | 138,778          | 129,355          | 126,709          | 124,311          | 132,698          | 1,488,649         |
| Arkëtimi-BM                             | 72,530           | 63,844           | 72,572           | 71,126           | 74,760           | 75,245           | 83,287           | 86,458           | 79,946           | 78,718           | 76,748           | 82,713           | 917,947           |
| Arkëtimi-institucione                   | 165,248          | 141,663          | 162,042          | 157,543          | 165,352          | 167,595          | 189,509          | 198,405          | 179,687          | 173,650          | 168,604          | 184,151          | 2,053,451         |
| Arkëtimi-shërbimet dytësore             | 21,824           | 16,872           | 19,484           | 16,527           | 15,046           | 19,068           | 22,490           | 16,016           | 22,839           | 20,080           | 13,068           | 19,163           | 222,477           |
| <b>Arkëtimi-Total</b>                   | <b>1,229,182</b> | <b>1,090,990</b> | <b>1,225,319</b> | <b>1,202,069</b> | <b>1,257,534</b> | <b>1,280,150</b> | <b>1,424,039</b> | <b>1,478,614</b> | <b>1,379,366</b> | <b>1,349,604</b> | <b>1,314,658</b> | <b>1,423,281</b> | <b>15,654,808</b> |
|                                         |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                   |
| Shp. e ujit                             | 76,309           | 66,545           | 67,647           | 76,904           | 74,047           | 70,476           | 78,051           | 65,352           | 72,067           | 72,132           | 60,921           | 68,463           | 848,912           |
| Shp. e energjisë                        | 239,650          | 231,497          | 202,412          | 213,248          | 218,755          | 211,199          | 219,507          | 216,158          | 221,170          | 221,025          | 220,628          | 221,417          | 2,636,666         |
| Shp. e karburanteve                     | 9,312            | 8,509            | 9,958            | 8,883            | 10,708           | 11,117           | 11,195           | 11,903           | 0                | 560              | 10,227           | 10,176           | 102,548           |
| Shp. e personelit                       | 492,007          | 484,124          | 452,077          | 478,707          | 476,559          | 455,793          | 472,460          | 462,095          | 444,020          | 453,755          | 448,096          | 613,613          | 5,733,305         |
| Shp. e materialit                       | 42,087           | 51,892           | 48,812           | 52,889           | 59,990           | 53,961           | 41,552           | 37,523           | 85,610           | 98,872           | 58,834           | 59,452           | 691,474           |
| Sherb. Kontraktuese                     | 41,418           | 29,267           | 31,498           | 19,285           | 192,284          | 34,096           | 29,850           | 29,634           | 37,562           | 32,862           | 176,901          | 43,793           | 698,449           |
| Shp. ndih. soli.                        | 6,342            | 0                | 471              | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 1,348            | 983              | 9,144             |
| Shp. miremb.& ripar.                    | 4,597            | 12,350           | 8,424            | 2,561            | 15,171           | 6,676            | 18,093           | 17,866           | 1,835            | 2,774            | 14,041           | 6,142            | 110,530           |
| Shp. tjera finan.                       | 3,068            | 3,157            | 7,611            | 584              | 2,345            | 1,022            | 430              | 3,217            | 48,310           | 2,443            | 2,254            | 152              | 74,592            |
